Në vijim në mënyrë tabelare i paraqesim aktivitetet e Divizionit të makinerisë gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2025

Tabela 16. Aktivitetet e Divizionit të makinerisë gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2025

nr	Përshkrimi i punëve	Data e kryerjes	Vërejtje
1	Pastrimi i këmbysëve të nxehtësisë: KN-1(ndërrimi i diktunave) dhe KN-2 (trajtjim me kimikale)	28.05.2025	Më datë 06.05.2025 ka filluar hapja e këmbyesit të nxehtësisë 1 në stacionin HRS dhe ka zgjatur deri më 28/05/2025, është kryer bashkë me PKU-në
2	Revizion i sistemit të mbajtjes së presionit në rrjet të koogjenerimit	08.05.2025	Është bërë revizion i sistemit të mbajtjes së presionit në rrjet të koogjenerimit dhe është riparuar goma e brendshme e enës ekspanduse
3	Drenazhimi nëpër puseta të koogjenerimit dhe mirëmbajtja e valvolave në puseta	12.05.2025	Janë kontrolluar të gjitha pusetat e vijës së koogjenerimit, janë përpunuar valvolat dhe është bërë drenazhimi
4	Kontrollimi si dhe testimi me ujë i sistemit të rezerveve të mazutit: R3 dhe R4	14.05.2025	Është bërë testimi me ujë i sistemit të rezervave të mazutit
5	Pastrimi i filterave të mazutit dhe filterat në stacionin e ri të mazutit	15.05.2025	Edhe pse nuk është përdorur është pastruar filteri
6	Kontrollimi i valvolave të rezervave të naftës	20.05.2025	Të gjitha valvolave të rezervave të naftës të ngrrohtorja e spitalit ju është bërë revizion
7	Kontrollimi i valvolave hyrje -dalje të pompave qarkulluese dhe kllapneve	26.05.2025	Është bërë kontrolli i të gjitha valvolave në hyrje dhe dalje të pompave qarkulluese dhe kllapneve
8	Pastrimi i filtrave të pajisja e degasifikimit	30.05.2025	Janë kontrolluar paisjet dhe është bërë pastrimi i filtrave të pajisja e degazifikimit
9	Kontrollimi i kllapneve jo kthyese DN300 mm, dhe kontrolli i filtrave në NQ	03/06/2025	Është bërë kontrolli i kllapneve jo kthyese të DN300, po ashtu edhe filtrat janë kontrolluar
10	Kontrollimi i valvolave dhe kllapneve para pompave riqarkulluese të Kaldajes K-2	03/06/2026	Janë kontrolluar të gjitha valvolat dhe kllapnet para pompave riqarkulluese të kaldajes K-2
11	Revizioni i pompës për mbushje të shpejtë (valvola kontrolluese)	04/06/2025	Është bërë revizioni i pompës për mbushje të shpejtë
12	Kontrollimi i valvolave nga zbutësat deri te rezervari ditor (ena ekspanduse)	05/06/2025	Është bërë kontrolli i të gjitha valvolave nga zbutësat e deri te rezervari ditor
13	Kontrollimi i matësve të ujit në dalje të zbutësve dhe matësve në kthim në rezervarin ditor	09/06/2025	Edhe matësve të ujit ju është bërë një kontroll detaj nga zbutësat deri te rezervari ditor
14	Pastrimi i filtrave të pompave qarkulluese	09/06/2025	Janë pastruar të gjithë filterat e pesë pompave qarkulluese
15	Revizioni i valvolave hyrje-dalje të kolektorëve	10/06/2025	Edhe valvolave në hyrje-dalje të kolektorëve ju është bërë revizion
16	Pastrimi i kanalit të vijës së mazutit nga kaldajat	11/06/2025	Kanali i vijës së mazutit është pastruar nga pluhuri dhe mbeturinat e ndryshme
17	Pastrimi i filterave në pjesën primare dhe sekondare, sipas nevojës edhe riparimi i tyre në në stacionin e "Bregut të Diellit"	12 /06/2025	Janë pastruar të gjitha filtrat në nëstacionin e "Bregut të Diellit"





18	Montimi i manometrave termometrave, ventilat e çajrosjes në stacionin B.D, sipas nevojës testimi i paisjes nën presion	17 /06/2025	Në nënstationin e B.Diellit janë ndërruar të gjithë manometrat, dhe janë testuar pajisjet nën presion
19	Revizion i pompave për mbajtjen e presionit në rrjet të kogjenerimit	18/06/2025	Pompave për mbajtjen e presionit të rrjetës së kogjenerimit ju është bërë revizion
20	Pastrimi i filterave të pajisja për mbajtjen e presionit, në rrjeten e kogjenerimit	19/06/2025	Janë pastruar të gjithë filtrat të paisja për mbajtjen e presionit të rrjetës së kogjenerimit
21	Revizioni i valvolave hyrje-dalje të kaldajave K1 dhe K2 të ngrontorja e spitalit	20/06/2025	Edhe valvolave në hyrje- dalje të dy kaldajave të ngrontorja e spitalit u është bërë revizion
22	Mirëmbajtja e pajisjeve në stacionin HRS	23/06/2025	Janë kontrolluar të gjitha pajisjet në stacionin e HRS-së dhe në ato që kanë pasë nevojë është intervenuar
23	Revizioni i pompës qarkulluese të mazutit	24/06/2025	Edhe pompës qarkulluese të mazutit i është bërë revizion
24	Revizioni i flakëruesit të kaldajës K-4	25/06/2025	Edhe pse kaldaja K-4 nuk ka pasur nevojë të përdoret, prapë i është bërë revizion total
25	Revizioni i rezervarit ditor të mazutit të kaldajës K-4	26/05/2025	Edhe rezervuarit të mazutit të kaldajës katër i kemi bërë revizion
26	Mirëmbajtja e pusetave të kogjenerimit	Korrik 2025	Më datë 06.05.2025 ka filluar hapja e këmbyesit të nxehtësisë 1 në stacionin HRS dhe ka zgjatur deri më 28/05/2025 është kryer bashkë me PKU-në
27	Pastrimi i mbetjeve të metalta nga oborri përreth ngrohtores	10.07.2025	
28	Revizioni i stacionit të ri të mazutit	11.08/2025	Është bërë revizion total i stacionit të mazutit, janë pastruar edhe filtrat
29	Kalibrimi valvolës siguruese të kaldajës K-4	15.08.2026	Është kalibruar dhe montuar valvola siguruese e kaldajës 4
30	Kalibrimi i valvolave siguruese 1 dhe 2 të ngrontorja e spitalit	18.08.2025	Janë kalibruar që të dy valvolat siguruese dhe janë montuar
31	Kalibrimi i valvolave siguruese të këmbyesëve: 1, 2, 3 dhe 4 dhe valvola siguruese e rrjetit në stacionin e "Bregut të Diellit"	19.08.2025	Edhe valvolat siguruese në stacionin e "Bregut të Diellit" janë kalibruar dhe montuar
32	Kalibrimi i valvolave siguruese të këmbyesëve të nxehtësisë: 1, 2, dhe 3 në HRS	20.08.2025	Edhe në stacionin e HRS janë kalibruar dhe montuar valvolat siguruese
33	Kalibrimi i valvolave siguruese të kondenzatorëve të nxehtësisë: 1 dhe 2 në HES	27.08.2025	Kurse kalibrimi i valvolave siguruese të këmbyesëve në stacionin e HES-it janë në proces
34	Pastrimi i filterit në hyrje të stacionit HRS	29.08.2025	Është pastruar filteri në hyrje të stacionit të HRS
35	Kontrollimi i valvolave hyrje- dalje të këmbyesëve dhe të tjera në stacionin e "Bregut të Diellit"	05.09.2025	Janë kontrolluar të gjitha valvolat në hyrje- dalje të këmbyesëve në nënstationin e "Bregut të Diellit"
36	Revizioni i valvolave në pjesën primare dhe sekondare, hyrje-dalje të objektit në stacionin e "Bregut të Diellit"	11.09.2025	Është bërë revizioni i valvolave në pjesën primare dhe sekondare, hyrje-dalje të objektit
37	Revizioni i pompave qarkulluese Etanorm, pompave qarkulluese (72P1, 71P2, 72P3), sipas nevojës në stacionin e "Bregut të Diellit"	12.09.2025	Edhe pompave qarkulluese në stacionin e "Bregut të Diellit" i është bërë kontrollë. Gjendja e tyre është e mirë dhe e gatshme për punë
38	Revizioni i enëve ekspanduese dhe valvolave përcjellëse në stacionin e "Bregut të Diellit"	12.09.2025	Janë kontrolluar enët ekspanduese dhe valvolat në stacionin e "Bregut të Diellit"
39	Kontrollimi i pompave qarkulluese në stacionin e ri të mazutit brenda objektit NQ	15.09.2025	Pompat të stacionit i ri i mazutit brenda objektit të NQ janë kontrolluar
40	Kontrollimi i manometrave dhe termometrave në stacionin e ri të mazutit, sipas nevojës ndërrimi i tyre në NQ	17.09.2025	Manometrat dhe termometrat në stacionin e ri të mazutit janë kontrolluar dhe janë funksional





41	Pastrimi i gypave të transmierave në stacionin HRS	16.09.2025	Janë pastruar të gjithë gypat e transmierëve në stacionin e HRS-së
42	Pastrimi i gypave të transmierave në stacionin HES Obiliq	11.09.2025	Edhe në stacionin HES-it në Obiliq janë pastruar të gjithë gypat e transmierëve
43	Mirëmbajtja e pajisjeve stabilimenteve në stacionin e HES-it Obiliq	10.09.2025	Të gjitha pajisjeve në stacionin e HES-it ju është bërë mirëmbajtja
44	Kontrolli i valvolave dhe pajisjeve tjera në stacionin e HES-it Obiliq	15.09.2025	Po ashtu edhe valvolat janë kontrolluar në HES
45	Montimi i pjesëve të pompave të kondenzatit në stacionin HES-it Obiliq	11.09.2025	Është bërë vetëm revizion i tri pompave të kondenzatit dhe është parë se janë në gjendje të rregullt dhe nuk kanë nevojë të montohen pjesët
46	Ndërrimi i valvolave DN200 në pjesën primare dhe sekondare në këmbyes të nxehtësisë		Nuk është kryer, mungojnë valvolat
47	Pastrimi i këmbyesit 1 në stacionin e "Bregut të Diellit"	25.09.2025	Janë pastruar fletëzat e këmbyesit 1 dhe është montuar pa probleme
48			

Në vijim në mënyrë të përmbledhur i paraqesim aktivitetet kryesore të Divizionit të makinerisë, gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2025:

Në përputhje me Planin aksional të miratuar për vitin 2025, Divizioni i makinerisë ka filluar dhe realizuar aktivitetet e planifikuara, me një nivel realizimi mbi **95%**. Gjatë vitit janë zhvilluar punë operative, mirëmbajtëse dhe intervenuese, duke siguruar funksionim stabil të sistemeve termoenergjetike dhe të kogjenerimit.

Tremujori i parë (janar–mars 2025)

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar aktivitetet kryesore si vijon:

- Mirëmbajtja e stabilimenteve termoenergjetike nga njësia e remontit;
- Pastrimi periodik i filtrave sipas nevojës në NQ, HES dhe termonënstacionin kryesor "Bregu i Diellit", në pjesën primare dhe sekondare;
- Pastrimi i filtrit **Part Flow (filter magnetik)**;
- Matje të vazhdueshme të temperaturave në pompa, me pajisje adekuate matëse për të gjitha pompat e departamentit;
- Largimi i ujit të grumbulluar në pusetën **MH-4**;
- Furnizimi me avull gjatë tremujorit të parë ka qenë stabil dhe i pandërprerë, duke u realizuar nga blloqet **TC Kosova B – B1 dhe B2**. Sipas planifikimit të KEK-ut, blloku **B1** është futur në remont të planifikuar;
- Në muajin **Mars 2025**, është realizuar testimi i performancës së rezervuarëve për ruajtjen e energjisë termike, në ngarkesë maksimale **50 MW**, në prani të kompanisë greke "ErgoTerm" dhe konsulencës përkatëse;
- Me datë **25.01.2025**, në intervalin kohor **05:00–06:00**, janë regjistruar luhatje të tensionit elektrik nga KEDS, si pasojë e të cilave pompat e kogjenerimit kanë dalë përkohësisht nga puna. Pas intervenimit të kujdestarëve, sistemi është rikthyer në funksion normal;
- Ngarkesa maksimale e pikut për këtë periudhë është regjistruar me datë **25.01.2025**, në ora **09:00**, me **117.6 MWh**, ndërsa temperatura mesatare ditore ka qenë **+6.0°C**. Ngarkesa mesatare tremujore ka qenë **85.2 MWh**, me temperaturë mesatare mujore **5.8°C**. Energjia termike e planifikuar është realizuar në nivelin **92.8%**;
- Në muajin **Janar 2025**, është realizuar betonimi i konstruksionit të pompës **123P001**, për shkak të vibrimeve të evidentuara, nga kompania "ErgoTerm";
- Me datë **04.03.2025**, gjatë punimeve nga punëkryesi i kontraktuar, është dëmtuar kabli furnizues **10 kV**, duke shkaktuar ndërprerje të furnizimit me energji elektrike dhe dalje nga puna të sistemit të ngrohjes në intervalin **15:00–17:00**;
- Nga data **15.03.2025**, pompa **123P001** është lëshuar në punë pas testeve në prani të "ErgoTerm", pa evidentim të rrjedhjeve të vajit pas vendosjes së bazës së betonit. Sistemi ka operuar vazhdimisht me dy pompa kogjenerimi, sipas planifikimit;
- Me datë **19.03.2025**, gjatë punimeve brenda hapësirave të ndërmarrjes, është dëmtuar kabli optik, duke shkaktuar humbje të





komunikimit me nënstacionin "Bregu i Diellit". Monitorimi është realizuar përkohësisht përmes vizitave fizike. Sanimi i kablilit është kryer më **27.03.2025**;

- Gjatë inspektimit të trasës së kogjenerimit më **28.03.2025**, është evidentuar dalje e avullit në segmentin **P368–P369**, në rrethrotullimin "Ismeti", Prishtinë. Kjo pikë është futur në planin e intervenimit për riparim të izolimit dhe është iniciuar procedura e prokurimit.

Muaji prill 2025

- Në muajin prill, furnizimi me avull është realizuar nga blloku **B2** i TC Kosova B, ndërsa blloku **B1** ka qenë në remont të planifikuar. Furnizimi me energji termike është realizuar përmes **KDN-2**, duke operuar në **Operation Mode 2**. Sezona ngrohëse **2024/2025** ka përfunduar zyrtarisht më **15.04.2025**;
- Janë realizuar:
- Mirëmbajtje e stabilimenteve termoenergjetike;
- Pastrim filtrash dhe filtrit magnetik;
- Matje temperaturash në të gjitha pompat;
- Inspektim i pusetave dhe trasës së kogjenerimit;
- Largim i ujit të grumbulluar në pusetën MH-4;
- Me datë **09–10.04.2025**, për shkak të daljes nga puna të bllokut **B2**, nuk ka pasur furnizim me avull për ngrohje. Për këtë arsye, QKUK është njoftuar zyrtarisht për pamundësinë e furnizimit;
- Me datë **15.04.2025**, është bërë pastrimi me kompresor i gypave në kondenzatorin e nxehtësisë 1, ku janë evidentuar mbetje metalike nga faza e instalimit të rrjetit të kogjenerimit;
- Në mbrëmjen e **15.04.2025**, sistemi është përgatitur dhe kaluar në **"Summer Mode"**, në koordinim me KEK-un, duke ndërprerë furnizimin me avull dhe duke ndalur pompat operative, përveç sistemeve të mbajtjes së presionit.

Periudha maj- shtator 2025:

- Gjatë kësaj periudhe janë realizuar aktivitete të mirëmbajtjes preventive, kontrollit teknik dhe projekteve të planifikuara, përfshirë:
- Mirëmbajtje dhe pastrim të pusetave të rrjetit të kogjenerimit;
- Testime operative të pompave **122P001** dhe **123P001**;
- Mbajtje e presionit në rrjetin e distribuimit sipas kërkesave operative;
- Shpenzime të rritura të ujit për shkak të drenazhimeve në HES dhe HRS;
- Implementimi i projektit **"Izolimi i gypave – Llaguna"** nga OE "AllZone";
- Inspektim dhe testim të kondenzatorëve të nxehtësisë në HES nga OE "Zelonis Kosova";
- Në muajin **shtator 2025**, është realizuar pastrimi kimik i këmbesit të nxehtësisë 1 në stacionin "Bregu i Diellit", ku është konstatuar konsumim i theksuar i fletëzave. Duke qenë se këmbesit janë në funksion, që nga viti 2004 dhe tenderët për ndërrim kanë dështuar, kërkohet riprocëdim i menjëhershëm i prokurimit për furnizim me dy këmbes të rinj.

Tetor–dhjetor 2025:

- Gjatë kësaj periudhe janë realizuar aktivitetet përgatitore dhe operative për sezonën ngrohëse **2025/2026**, përfshirë:
- Fillimin e furnizimit me avull nga blloku **B1** (07.10.2025);
- Përgatitjen e sistemit për furnizim të QKUK-së;
- Aktivizimin e pajisjeve të degazifikimit dhe rezervuarëve Heat Storage;
- Operim sezonal sipas ngarkesës termike;
- Evidentim dhe raportim të ndërprerjeve të energjisë elektrike dhe kufizimeve nga KEK-u;
- Inspektim të trasës së kogjenerimit dhe njoftim të OE për sanim të izolimit në pikat në garancion.

Përfundim

Bazuar në realizimin e planit aksional për vitin 2025, Divizioni i makinerisë është **teknikisht i përgatitur për sezonën ngrohëse 2025/2026**,






me përjashtim të problematikës së këmbysesëve të vjetëruar në stacionin “Bregu i Diellit”, për të cilët kërkohet zgjidhje urgjente përmes procedurave të prokurimit.

Divizioni i elektrikës

Në vijim në mënyrë tabelare janë paraqitur aktivitetet e Divizionit të elektrikës:

Tabela 17 Aktivitetet e Divizionit të elektrikës gjatë vitit 2025

Nr.	Përshkrimi i punëve	Data e kryerjes	Vërejtje
1	Tensioni i mesëm (10kV); Pastrimi dhe kontrollimi i tepihave izolues në trafostacion. Kthinat e tensionit të mesëm 10kV, me projektin e kogjenerimit janë ndërruar tërësisht, prandaj nuk ka nevojë për ndonjë intervenim dhe është bërë vetëm kontrollimi dhe pastrimi i tyre. Mirëpo, për shkak të kalimit nga KEDS në tensionin 20kV, të gjitha kthinat duhet të ndërrohen	06.05.2025	Është bërë pastrimi i tepihave izolues në trafostacion
2	Kontrollimi dhe intervenimi në ndriçimin brenda dhe jashtë ndërtesës së prodhimit dhe në rastet e nevojshme instalimi i ndriçimit automatik me sensor	18.07.25	Është zëvendësuar ndriçimi, nga ato neon në panela led, duke filluar në zyrën e PKU-së, në korridore, për të vazhduar në dhomën e tensionit 10kV/0.4kV, në dhomën e gjeneratorit, në korridorin përdhësë dhe katin e parë (tek zyret e inxhinierëve)
3	Pastrimi i të gjitha PC-ve në dhomën e kontrollit dhe punët tjera në pultin komandues; Serverët në pultin komandues; PC-ja për stacionin “Bregu i Diellit” e vendosur në pultin komandues; PC-ja për ES Client. Pastrimi i pajisjeve elektronike në pultin komandues; Rregullimi dhe përforcimi i përçuesëve në kanale; Ndërrimi i butonëve të dëmtuar; Kompletimi me llamba për sinjalizim;	13.10.25	Janë përfunduar punët me pastrimin e serverëve, PC-ve, rregullimin e përçuesëve në kanale dhe gjitha pajisjeve përcjellëse në HRS
4	Përpilimi i kërkesës dhe pastaj instalimi i switch-it për selektim të PC-ve dhe monitorit mes displayport dhe HDMI		Dështimi në herën e parë dhe tani kërkesa është në ritender, ku përfshihet edhe switch-i
5	Inverterët VFD të pompave të kogjenerimit 121P001-122P001-123P001: Pastrimi i filtrave për inverterët VFD; Shtrëngimi i kabllove në inverterët VFD; Kontrollimi dhe verifikimi i funksionalitetit të sinjaleve komanduese	27.05.25	Është bërë pastrimi i filtrave të inverterëve VFD për pompat e kogjenerimit, shtrëngimi i përçuesve në rastet e nevojshme dhe verifikimi i funksionalitetit të sinjaleve
6	Elektromotorët e pompave të kogjenerimit 121P001-122P001-123P001 (P=980 kW, U=690V): Pastrimi i elektromotorëve; Hapja e klembertëve, Kontrollimi dhe shtrëngimi i kabllove furnizuese	22.05.25	Është bërë pastrimi i elektromotorëve të kogjenerimit dhe hapja e klembertave për kontrollimin dhe shtrëngimin e përçuesve në rastet e nevojshme
7	Inverterët Vfd të pompave të distribuimit 62P1-62P5: Pastrimi i 5 inverterëve VFD. Shtrëngimi i kabllove në inverterët VFD. Kontrollimi dhe verifikimi i funksionalitetit të sinjaleve komanduese;	02.06.25	Është bërë pastrimi i filtrave të panelave furnizues të inverterëve Vfd për pompat e distribuimit, shtrëngimi i përçuesve në rastet e nevojshme dhe verifikimi i funksionalitetit të sinjaleve.






8	<p>Elektromotorët e pompave qarkulluese të distribuimit 62P1-62P5 (P=980 kW, U=690V): Pastrimi i elektromotorëve; Hapja e klembertëve,3. Kontrollimi dhe shtrëngimi i kabllove furnizuese; Vërejtje: Nëse shkon mbarë, kemi buxhet të planifikuar për freskimin e elektromotorëve të pompave 62P1 dhe 62P2.</p>	14.05.25	<p>Është bërë pastrimi i elektromotorëve të pompave qarkulluese dhe kontrollimi i kabllove nëse janë mjaftueshëm të fiksuara. Ndërsa ka dështuar tenderi për freskimin e elektromotorëve të pompave 62P1 dhe 62P2.</p>
9	<p>Inverteri Vfd i pompës së distribuimit 62P1: Është bërë planifikimi i buxhetit për ndërrimin e inverterit në fjalë, i vjetër më shumë se 20 vjet.</p>	14.11.25	<p>Më datën 03.11 ka filluar punën OE BF Energy në instalimin e inverterit të ri Vfd, e cila ndërlidhet me pompën qarkulluese 62P1 dhe më datën 14.11 ka vënë në punë. Më datën 18 Nëntor në ora 23:05 kemi pasë problem me inverterin prandaj edhe më datën 19 nëntor prezent ishte OE BF Energy në lidhje me problemin, mirëpo pa sukses në funksionalizimin e inverterit. Më datën 20 nëntor kam informuar OE edhe përmes email-it dhe më datën 26.11.2025 OE ka ndërruar shndërruesin 220VAC/24VDC, njëkohësisht edhe kemi startuar me inverterin Vfd. Fillimisht është startuar me kapacitetin 70%, ndërsa në datën 27.11.2025 është ngritur kapaciteti i pompës në 90% dhe vazhdojmë të punojmë me këtë pompë</p>
10	<p>Transmimerët e shtypjes: Kontrollimi i transmimerëve dhe pastrimi i gypave impulsiv i të gjithë transmimerëve; Kontrollimi i kabllove të sinjaleve komanduese, nga pajisjet deri në pulstin komandues;</p>	09.06.25	<p>Janë kontrolluar kabllo të sinjaleve komanduese për transmimerët e shtypjes dhe pastrimi i gypave impulsive</p>
11	<p>Pajisjet për matjen e temperaturës: Testimi i termoelementeve, pastrimi i tyre nga mbeturinat dhe ndërrimi i tyre në rastet e nevojshme. Kontrollimi i kabllove të sinjaleve komanduese, nga pajisjet deri në pulstin komandues;</p>	26.09.2025	<p>Është bërë kontrollimi dhe testimi i pajisjeve për matjen e temperaturës në HRS</p>
12	<p>Pajisjet për matjen e nivelit: Testimi i pajisjeve të nivelit dhe pastrimi i tyre nga mbeturinat në rastet e nevojshme. Kontrollimi i kabllove të sinjaleve komanduese, nga pajisjet deri në pulstin komandues;</p>	16.09.2025	<p>Pastrimi dhe testimi i nivel matësve në rezervuarët e kogjenerimit dhe testimi i tyre</p>
13	<p>Kontrollimi i pajisjeve për matjen e rrjedhjes dhe energjisë termike.</p>	12.05.25	<p>Kemi bërë kontrollimin e pajisjeve për matjen e rrjedhjes dhe energjisë termike në HRS</p>
14	<p>Pjesa e tensionit të ulët TU (0.4kV); Kontrollimi, pastrimi dhe shtrëngimi i zbarrave të TU; Verifikimi i funksionalitetit të ndërprerësve DU-2000 dhe pastrimi i kontakteve të tyre; Kontrollimi i të gjitha kabllove që kalojnë në zbarrat e TU dhe shtrëngimi i tyre;</p>	18.08.25	<p>Është bërë kontrollimi, pastrimi i zbarrave, kontrollimi i kabllove dhe verifikimi i funksionalitetit gjatë kohës sa është bërë pastrimi i transformatorëve nga OE</p>
15	<p>Elektromotorët dhe inverterët Vfd të pompave për mbajtje të presionit të kogjenerimit 160P001-160P003 Pastrimi i elektromotorëve dhe inverterëve Vfd. Shtrëngimi i kabllove në elektromotorë dhe inverterët Vfd. Kontrollimi dhe verifikimi i funksionalitetit të sinjaleve komanduese;</p>	23.05.25	<p>Është bërë pastrimi i elektromotorëve dhe inverterëve Vfd për pompat e mbajtjes së presionit në sistemin e kogjenerimit</p>
16	<p>Elektromotorët dhe inverterët Vfd të pompave për mbajtje të presionit të distribuimit 63P3, 63P5 dhe 62P6: Pastrimi i elektromotorëve dhe inverterëve Vfd. Shtrëngimi i kabllove në elektromotorë dhe inverterët Vfd; Kontrollimi dhe verifikimi i funksionalitetit të sinjaleve komanduese;</p>	20.06.25	<p>Janë pastruar elektromotorët, inverterët Vfd dhe janë kontrolluar kabllo furnizuese</p>



17	Inverteri VFD i elektromotorit të mbajtjes së presionit 63P4.	21.11.25	Nënkontraktori grek Powertronik (i angazhuar nga kompania Ergotem) ka ndërruar inverterin VFD për pompën e mbajtjes së presionit të distribuimit 63P4, e cila ishte dëmtuar rreth 1 vit më parë
18	Elektromotorët e pompave riqarkulluese, 31P2 dhe 41P2, P=90kW: Pastrimi i elektromotorëve dhe inverterëve VFD; Shtrëngimi i kabllove në elektromotorë dhe inverterët VFD; Kontrollimi dhe verifikimi i funksionalitetit të sinjaleve komanduese;	23.05.25	Është bërë pastrimi i elektromotorëve të pompave riqarkulluese 31P2, 41P2, shtrëngimi i përçuesve dhe verifikimi i funksionalitetit të sinjaleve
19	Pajisjet e nevojshme elektrike për kyçjen direkte të pompave 31P1 dhe 41P1: Pastrimi i kontakteve të KS-160A; Shtrëngimi i kabllove; Kontrollimi dhe verifikimi i funksionalitetit të sinjaleve komanduese;	23.05.25	Është bërë pastrimi i elektromotorëve të pompave riqarkulluese 31P1,41P1, shtrëngimi i përçuesve dhe verifikimi i funksionalitetit të sinjaleve
20	Elektromotorët e ventilatorëve të K1 dhe K2, P=250kW: Pastrimi i elektromotorëve dhe inverterëve VFD; Shtrëngimi i kabllove në elektromotorë dhe inverterët VFD; Kontrollimi dhe verifikimi i funksionalitetit të sinjaleve komanduese;	26.05.25	Është bërë pastrimi i elektromotorëve dhe inverterëve VFD të ventilatorëve të K1 dhe K2 (P=250kW), shtrëngimi i përçuesve tek inverterët VFD dhe verifikimi i funksionalitetit të sinjaleve. Ndërsa gjendja tek klembertat ishte në rregull pas intervenimit vitin e kaluar me silikon
21	Kontrollimi i panelit elektrik të baterive përmes së cilës furnizohen panelet për tregimin e parametrave elektrik në trafostacione	03.06.25	Është kontrolluar dhe pastruar paneli elektrik i baterive
22	Kontrollimi, testimi dhe nëse është e domosdoshme edhe ndërrimi i baterive të UPS-it, i cili furnizon komplet panelin komandues të sistemit automatik të kontrollit në HRS	08.10.25	Fillimisht ishte kontrolluar UPS-i, i cili ishte dëmtuar dhe bateritë të cilat ishin të shpenzuara. Pastaj provuam përmes një servisi të jashtëm, mirëpo vetëm pas porosities së baterive nga vetë ne si division dhe intervenimit në UPS kemi vënë në funksion UPS-in
23	Panelat komandues për K-1 dhe K-2 (Petrokraft dhe Saacke) Pastrimi i panelave elektrik; Kompletimi i dritave sinjalizuese; Kontrollimi i kontaktorëve për flakërues dhe ventilator të ajrit primar; Kaldajat nuk janë në punë prej disa vitesh, prandaj duhet të verifikohet gjendja e pajisjeve elektrike dhe të mbyllen panelet komandues	10.06.25	Është bërë pastrimi i paneleve komanduese K-1 dhe K-2 (Petrokraft dhe Saacke) dhe janë kontrolluar gjendja me dritat sinjalizuese
24	Nxemsat elektrik në gypat e mazutit të K1 & K2 Kontrollimi i nxemsave në gypa; Izolimi i gypave, aty ku është e nevojshme;	08.07.25	Janë kontrolluar nxemsat elektrik në gypat e mazutit dhe nuk ka pasur nevojë për ndonjë izolim
25	Nxemësi elektrik i mazutit P=150kW Kontrollimi i nxemsave, pastrimi dhe shtrëngimi i klembertit; Pastrimi dhe kontrollimi i panelit komandues; Kontrollimi i ventilatorëve për ftohje; Pastrimi i kontakteve të kontaktorit kryesor;	05.06.25	Është bërë kontrollimi, pastrimi dhe shtrëngimi i klembertit të nxemshit elektrik P=150kW
26	Pas përfundimit të punëve dhe përfundimit të projektit për zgjerim, planifikojmë upload-in e programeve nga PLC-të, të cilat janë në operim brenda në NQ: PLC Siemens – CPU 414-5H në NQ;		Për shkak të vonesave të konsiderueshme të kontraktorit Ergotem, ende nuk kemi versionin final të softuerit të PLC-së dhe SCADA
27	Kaldaja Nr. 3 (Kaldaja për nevoja të brendshme) Kontrollimi i flakëruesit; Kontrollimi i pompës qarkulluese dhe sinjaleve komanduese; Kontrollimi i nxemsave në rezervuarin ditor. Kompletimi i ndriçimit në kthinën e kaldajës;	09.07.25	Është kontrolluar kaldaja nr.3, përfshirë flakëruesin, sinjalet komanduese dhe pompën qarkulluese



28	Zëvendësimi i panelit ekzistues elektrik në dhomën tek gjeneratori me panel të ri elektrik dhe njëkohësisht kompletimi i panelit me komponentet e nevojshme;	05.08.25	Kemi përfunduar punën me panelin elektrik në dhomën tek gjeneratori, me ç' rast paneli i vjetër dhe me gjëra të panevojshme është zëvendësuar me panelin e punuar nga ne dhe është instaluar në pozicionin përkatës
29	Kontrollimi dhe testimi i funksionalitet të gjeneratorit 150kVA.	21.05.25	Është kontrolluar dhe testuar funksionaliteti i gjeneratorit 150kVA dhe është në rregull
NËNSTACIONI HES			
30	Elektromotorët dhe inverterët Vfd të pompave qarkulluese të kondenzatit. Pastrimi i elektromotorëve dhe inverterëve Vfd; Shtrëngimi i kabllove në elektromotorë dhe inverterët Vfd; Kontrollimi dhe verifikimi i funksionalitetit të sinjaleve komanduese;	25.09.25	Kemi bërë pastrimin e inverterëve Vfd dhe elektromotorëve në stacionin HES, njëkohësisht edhe kontrollimi i sinjaleve komanduese. Përveç saj, është pastruar në tërësi stacioni nga brenda
31	Transmimerët e shtypjes: Kontrollimi i transmimerëve dhe pastrimi i gypave impulsiv i të gjithë transmimerëve; Kontrollimi i kabllove të sinjaleve komanduese, nga pajisjet deri në panelin kryesor të sinjaleve;	11.09.25	Kemi bërë pastrimin e gypave impulsiv të transmimerëve të shtypjes së bashku me divizionin e makinerisë dhe kemi bërë kontrollimin e sinjaleve komanduese
32	Pajisjet për matjen e temperaturës: Testimi i termoelementeve, pastrimi i tyre nga mbeturinat dhe ndërrimi i tyre në rastet e nevojshme. Kontrollimi i kabllove të sinjaleve komanduese, nga pajisjet deri në panelin kryesor të sinjaleve;	11.09.2025	Është bërë kontrollimi dhe testimi i termoelementeve dhe sinjaleve komanduese
33	Pajisjet për matjen e nivelit: Testimi i pajisjeve të nivelit, pastrimi i tyre nga mbeturinat dhe ndërrimi i tyre në rastet e nevojshme. Kontrollimi i kabllove të sinjaleve komanduese, nga pajisjet deri në panelin kryesor të sinjaleve;	01.10.25	Janë testuar dhe kontrolluar pajisjet për matjen e nivelit dhe kontrollimi i sinjaleve komanduese
34	Kontrollimi dhe testimi i baterive të UPS-it, i cili furnizon komplet panelin komandues të sistemit automatik të kontrollit në HES	15.05.25	Është bërë kontrollimi i baterive të UPS-it, që rezulton të jetë në rregull
35	Kontrollimi dhe testimi kalkulatorit të energjisë në stacionin HES	13.10.25	Për shkak të punëve, që janë zhvilluar në këmbyes dhe papastërtive atje, kjo punë është bërë me vonesë nga ajo që ishte planifikuar
36	Testimi dhe në rastin e nevojshëm vendosja e baterisë për transmimerin e instrumentit të rrjedhjes në dy linjat e ngrohjes	13.10.25	Për shkak të punëve, që janë zhvilluar në këmbyes dhe papastërtive atje, kontrollimi dhe testimi i dy instrumenteve të rrjedhjes ishte më vonë krahasuar me atë që ishte planifikuar
Nënstacioni kryesor "Bregu i Diellit"			
37	Kontrollimi i kontrollit të programueshëm PLC, releve, shndëruesve dhe pjesëve tjera përbërëse të panelit komandues	15.07.25	Është bërë kontrollimi i kontrollit të PLC, releve dhe pjesëve tjera të panelit komandues në stacion
38	Trafostacioni 10/0.4 kV Kontrollimi i pjesës së TM dhe TU; Pastrimi i zonës së trafos dhe pajisjeve tjera përcjellëse; Kontrollimi dhe pastrimi i panelit për furnizim dhe komandim;	18.08.25	Është bërë pastrimi i transformatorit dhe janë kontrolluar pjesa e TM dhe TU gjatë kohës kur është bërë inspektimi i transformatorëve tjerë nga OE
39	Elektromotorët dhe inverterët Vfd të pompave qarkulluese. Pastrimi i elektromotorëve dhe inverterëve Vfd; Shtrëngimi i kabllove në elektromotor dhe inverterët Vfd; Shtrëngimi i përcuesëve elektrik në ndërprerësit termik për tri pompat qarkulluese; Kontrollimi dhe verifikimi i funksionalitetit të sinjaleve komanduese;	17.09.25	Kemi bërë pastrimin, shtrëngimin e përcuesëve, kontrollimin e elektromotorëve, inverterët Vfd dhe testimi i sinjaleve komanduese
40	Kontrollimi i pajisjeve në sistemin për mbajtje të shtypjes në stacionin "Bregu i Diellit"	15.08.25	Kemi kontrolluar sistemin për mbajtje të shtypjes
41	Kontrollimi i ndriçimit të jashtëm dhe modifikimi i ndriçimit të	08.08.25	Është përfunduar puna me gjithë instalimin e ndriçimit të brendshëm i bazuar në



	brendshëm në stacionin "Bregu i Diellit"		reflektor, përfshirë gjithë pjesët përbërëse (kablo, lidhëse, ndërprerësa etj). Njëkohësisht kemi përfunduar punën me ndriçimin e jashtëm në stacionin "Bregu i Diellit", në të cilën rast kishte mungesë furnizimi dhe njëkohësisht kemi zëvendësuar poçat elektrike me reflektor. Përveç saj, është instaluar sensori dhe ndriçimi i jashtëm bëhet në mënyrë automatike
Ngrohtorja e Spitalit			
42	Trafostacioni 10/0.4 kV: Kontrollimi i pjesës së TM dhe TU; Pastrimi i zonës së trafos dhe pajisjeve tjera pëcjellëse; Kontrollimi dhe pastrimi i panelit për furnizim dhe komandim;	18.08.25	Është bërë pastrimi i transformatorit dhe janë kontrolluar pjesa e TM dhe TU gjatë kohës, kur është bërë inspektimi i transformatorëve tjerë nga OE
43	Pajisjet elektrike në kaldajën K-1 dhe K-2: Kontrollimi, pastrimi dhe kompletimi i paneleve komanduese të kaldajave; Kontrollimi dhe evitimi i gabimeve eventuale në pajisjet e flakëruesëve (ventilat e gazit, naftës, trafos së TM, fotocelulës etj.); Kontrollimi dhe kalibrimi i presostatëve dhe termostatëve mbrojtës për dy kaldajat; Kontrollimi dhe testimi i pompës për furnizimin me naftë;	19.05.25	Kemi bërë kontrollimin dhe pastrimin e pajisjeve elektrike në kaldajën K1 dhe K2
44	Elektromotorët e pompave qarkulluese (P=37kW dhe P=50kW, U=400V); Pastrimi i elektromotorëve; Hapja e klembertëve, kontrollimi dhe shtrëngimi i kabllove furnizuese; Kontrollimi dhe shtrëngimi i përqesve në kontaktor dhe mbrojtje termike;	19.05.25	Pas hapjes së klembertave, janë kontrolluar përqesit në elektromotorët e pompave qarkulluese dhe pastrimi i tyre
45	Instalimi i sensorit dhe mundësimi i funksionimit automatik të ndriçimit të jashtëm në Ngrohtoren e spitalit. Njëkohësisht kontrollimi dhe kompletimi i ndriçimit të brendshëm	24.04.25	Është bërë automatizimi i ndriçimit të jashtëm në ngrohtoren e spitalit. Material harxhues: 1. Sensor ndriçimi 2. Kabëll
Jashtë planit aksional			
46	Inspektimi i transformatorëve, tokëzimit dhe rufepritësit brenda NP "Termokos"	18.08.25	Nga kompania Risamont, është bërë inspektimi dhe pastrimi i 4 transformatorëve brenda ndërmarjes sipas kontratës, e cila njëkohësisht ishte kërkesë edhe e inspektoratit (të paraplanifikuar nga ana jonë) dhe është përfunduar puna, ndërsa më herët ishte bërë inspektim edhe i tokëzimit dhe rufepritësit. Në fund kemi pranuar raportin final
47	Pastrimi i rrejtave rreth transformatorëve	11.08.25	Kemi bërë pastrimin e rrejtave rreth katër transformatorëve në ndërmarje
48	Problem me mungesë të disa sinjaleve të këmbësimit 1 në stacionin HES	26.08.25	Kemi identifikuar problemin me njërin nga modulet e PLC-së në stacionin HES dhe kemi rregulluar problemin në fjalë
49	Inspektimi i njehsorëve të energjisë elektrike në stacione	Shtator	Për shkak të dyshimeve, deri më tani kemi inspektuar njehsorët e energjisë elektrike në distribuim me shifrat si vijon: DPR90153301, DPR90179783, DPR90179796, DPR90180133, DPR90095284, DPR90007021, DPR90007019, DPR90007111, DPR90007123, DPR90007051, DPR90007052, DPR90007128, DPR90089840, DPR90153301, DPR 90007098 dhe kemi vërejtur shpenzim joracional përfshirë edhe keqpërdorim, për të cilën është bërë proces verbal. Pas intervenimit, kemi ndikuar në kursim financiar
50	Problem me humbje të disa sinjaleve në këmbësin nr. 2 në stacionin HES	Shtator	Problemi ishte i ngjajshëm me rastin e muajit gusht, respektivisht është djegur moduli sigurues (HES_AS_001-5F6). Pas hapjes së modulit vërehet depërtim i lagështisë nga avulli apo uji, e cila mund të jetë nga havoria me avull në sezonën paraprake
51	Ndriçimi në HRS	02.09.25	Kemi intervenuar në ndriçimin e dëmtuar nga depërtimi i ujit në HRS



52	Rregullimi i problemit me displej-in për tensionin dhe rrymën në kthinën e tensionit të ulët 690V	10.09.25	Është rregulluar problemi me displej-in e tensionit dhe rrymës në kthinën e tensionit të ulët 690V në HRS dhe tani kemi informacionin për tensionin dhe rrymën
53	Gabim nga ana e KEK-ut në faturën DPR90171476 në distribuim, e cila është faturuar 1,227.61€ në vend të 1€	12.09.25	Sërisht janë vërejtur gabime (fatura më të larta), për të cilën çështje ju kemi adresuar me email Kek-ut, duke mos dëmtuar buxhetin e ndërmarjes
54	Shfaqja në SCADA e alarmit "Emergency stop HRS"	19.09.25	Është shfaqur alarmi "Emergency stop HRS", prandaj pas shumë përpjekjeve dhe testeve të bëra kemi arritur t'a gjejmë prerdhjen e problemit "Emergency stop HRS"
55	Takim në inspektorat për gjendjen e transformatorëve 10kV brenda ndërmarjes.	16.09.25	Në inspektorat (Ministria e Ekonomisë) kemi dërguar raportin e inspeksionit të 4 transformatorëve brenda ndërmarjes NP "Termokos" dhe është diskutuar rreth hapave që janë ndërmarë dhe do të ndërmiren në aspektin elektroenergjetik
56	Takim me Brunata & Ergotem	24.09.25	Kemi pasur një takim në lidhje me zhvillimin e punëve të zgjerimit të kapacitetit, ndërlidhur me tenderin 1 (Brunata&Ergotem)
57	Email dërguar komisionit për OE "Limit"	15.10.25	Është pasruar puseta e kablilit 10kV nga gurët dhe përmes email-it për OE Limit kemi kërkuar kujdes të shtuar gjatë punëve, që do të bëhen në zonën afër pusetës.

Gjatë periudhës raportuese në Divizionin e Elektrikës, bazuar edhe në planin aksional 2025, janë realizuar këto punë:

- Më datën 07.01.2025, përmes nënkontraktorit Powertronik është vënë në funksion informacioni i tensionit komandues për sistemin e dozimit të distribuimit nga PLC.
- Më datën 08.01.2025 kemi shkyçur pompën e kogjenerimit 122P001 dhe kemi kyçur pompën 123P001, e cila ka punuar deri më datën 14 janar. Më datën 14.01.2025 kemi shkyçur pompën e kogjenerimit 123P001 për shkak të rrjedhjes së vajit dhe njëkohësisht kemi informuar kontraktorin Ergotem për problemin në fjalë, ndërkohë kemi kyçur pompën 122P001. Më datën 27.01.2025 kanë ardhur kompania Novomat (përfaqësues për KSB), ftuar nga kontraktori Ergotem, në lidhje me problemin e rrjedhjes së vajit në pompën e kogjenerimit 123P001. Më datën 20 shkurt, prezent ishin disa punëtorë të makinerisë nga Ergotem, të cilët kanë punuar në pompën e kogjenerimit 123P001. Më datën 20.03.2025 është kyçur në punë pompa 3 e kogjenerimit për të inspektuar gjendjen punuese të saj, kërkuar nga drejtori i kontraktorit Ergotem. Pastaj është punuar me pompën 123P001 deri në përfundim të sezonës 2024/25 dhe nuk kemi vërejtur rrjedhje të vajit.
- Më datën 27.02.2025 – 28.02.2025 prezent në ndërmarje ishte kompania Horn & Co. Analytics e angazhuar nga Ergotem, me qëllim të marrjes së mostrave nga uji i përgaditur dhe ai në kthinë dhe shikimit të efektit të sistemit të degazifikimit në distribuim.
- Më datën 05.03.2025, në prezencë të nënkontraktorit Powertronik dhe konsulencës, përfshirë Alexander Scholl dhe Fatmir Kelmendi është bërë testi i performancës në disa sisteme, si vijon:
 - Testimi i rezervuarëve në mbushje dhe zbrazje në rreth 50MW;
 - Sistemi i mbajtjes së presionit;
 - Part flow filteri;
 - Mixer valve;
 - Rezervuari ditor.
- Në prezencën e drejtorit të kontraktorit Ergotem është intervenuar në gypin furnizues për rezervuarin termik dhe pas intervenimit nuk është vërejtur rrjedhje e ujit.
- Në nëntor të vitit 2025, nga kompania Ergotem është vënë në funksion sistemi i dozimit në modin manual dhe është bërë zgjidhje rreth problemit të startimit të filtrit magnetik nga SCADA. Pastaj është bërë instalimi i analizatorit të PH-së dhe duket se vlerat e analizatorit janë të sakta.
- Nga data 01.12.2025 – 04.12.2025 është kyçur nga distanca (remotely) nënkontraktori Powertronik, i angazhuar nga Ergotem për funksionalizimin e sistemit të dozimit në modin automatik dhe njëkohësisht edhe për gjithë përkthimin e SCADA-së në gjuhën shqipe. Gjatë gjithë kohës kam qenë i angazhuar për të asistuar në punët e lartpërmendura.
- Gjatë gjithë kohës kemi qenë në kontakt me Aleksandrin nga konsulencia në lidhje me punët, që janë në obligim të kontraktorit Ergotem, gjithashtu është punuar në SCADA në nxjerrjen e arkivës për disa nga instrumentet në SCADA për HES dhe marrjen e CSV file në lidhje me mospërputhjen e vlerave të energjisë në hyrje dhe dalje të këmbësëve. Përveç saj, kemi bërë edhe testimin e instrumenteve të rrjedhjes për totalin dhe degën "Bregu i Diellit" dhe të njëjtat rezultate i kemi dërguar tek konsulencia, specifikisht tek Alexandri.



- Më datën 16 dhjetor prezent në ndërmarrje ishte drejtori i kompanisë Ergotem, i cili kishte angazhuar sërish kompaninë laboratorike për të marrë mostra në hyrje dhe dalje të sistemit të degazifikimit në distribuim. Analizat janë larg pritshmërive dhe nuk kemi ndonjë përgjigje se si do të veprohet. Ndërsa i njëjti ka dorëzuar AS-built-in e mbetur, të cilën njëkohësisht e kemi arkivuar dhe kopjen e kemi marrë për interes të prodhimit.
- Pas sjelljes së materialit sipas kërkesës së bërë, më datën 10.01.2025 kanë ardhur teknikët nga operatori "Dynamic" dhe janë shfrytëzuar pjesët përbërëse për të shtrënguar mbrojtjen tek pompa qarkulluese 72P2 në stacionin "Bregui i Diellit".
- Oscilimet dhe ndërprerjet e energjisë elektrike:
- Më datën 24.01.2025 në ndërrimin e dytë ka pasur oscilime të tensionit dhe pas 25min sistemi është rikthyer në normalitet.
- Më datën 02.04.2025 në ndërrimin e dytë ka pasur luhatje të tensionit me ç'rast janë resetuar pompat qarkulluese 62P1 dhe 62P4.
- Më datën 22.09.2025, për shkak të punëve nga ana e KEDS-it nuk kemi pasur energji elektrike nga ora 11:00-14:00 dhe gjatë kësaj kohe në zonat e mundshme kemi qenë të furnizuar nga gjeneratori.
- Më datën 08.10.2025 kemi pasur ndërprerje pa paralajmërim të energjisë elektrike nga KEDS, duke qenë në situatë të vështirë për shkak të fillimit të sezonës ngrohëse dhe rrezikut për dëmtimin e pajisjeve, për të cilin fakt gjatë gjithë kohës kemi qenë në kontakt me koordinatorin në KEDS. Ndërprerja e energjisë elektrike ka qenë nga ora 10:00- 10:10, 10:15- 10:45 dhe 13:55- 15:27.
- Më 12.11.2025 nga ora 06:00- 06:30 kishte ndërprerje pa paralajmërim të energjisë elektrike dhe pastaj rikyçja e sistemit në punë ishte pa probleme.
- Më datën 17.11.2025 ora 04:45, ka pasur luhatje të tensionit me ç'rast janë ndalur pompa e kogjenerimit 122P001 dhe pompat qarkulluese 62P4, 62P5.
- Më 19.11.2025 ora 14:25, kemi pas oscilime të tensionit, prandaj edhe janë shkyqur nga furnizimi të gjitha pompat dhe vetëm rreth orës 14:50 sistemi është rikthyer në funksion.
- Pas angazhimit për pagesën e një pjese të madhe të borxhit në KESCO, pastaj identifikimit të borxhit, që KESCO ka ndaj NP "Termokos", kam ndikuar, që në KESCO të bëhet komisioni rreth këtij borxhi dhe në muajt vijues të kompensohet në fatura. Mirëpo, edhe përkundër shumë email-ave nuk ka pas ekzekutim të kompensimit, respektivisht barazimit të faturave nga KESCO.
- Pas kontratës mes ndërmarrjes NPB dhe NP "Termokos" për lokalin në lagjen "Dardania", më datën 11.02.2025 është kërkuar, që fatura me shifrën DPR 90002338 të futet në listën e faturave të distribuimit.
- Kemi intervenuar në pompën e filtrit magnetik 64P1, e cila ishte në gabim, me ç'rast është pastruar filteri, janë bërë intervenimet e nevojshme të operimit dhe është rikthyer në funksion.
- Më datën 19.02.2025 kemi pranuar mallin nga kërkesa e fundit e vitit 2024 dhe të gjitha kërkesat e vitit 2024 janë të përfunduara me sukses.
- Më datën 20.02.2025 kemi vënë në punë sistemin e degazifikimit duke marrë ujin e përgaditur për degazifikim.
- Është përfunduar puna me ndërrimin e 12 dritave nga neon në ato led në dhomën e kontrollit.
- Është intervenuar në ndriçim në kabinën e punëtorëve në HES meqenëse ishte ndërprerë furnizimi tërësisht.
- Më datën 11.03.2025, pas punëve që janë bërë nga OE në oborin e NP "Termokos", rreth orës 09:00 është dëmtuar kablo furnizuese 10kV, e cila vjen direkt nga NS Prishtina 6 në KEDS. Fatmirësisht, kemi pas një kablo rezervë dhe në bashkpunim edhe me KEDS-in kemi rikthyer furnizimin me energji elektrike në ndërmarrje. Pas kësaj havarie dhe ndaljes së dhunshme të procesit, janë paraqitur probleme në kyçjen e pompave të kogjenerimit. Më pas intervenimi në HES kemi rregulluar problemin, kemi kyçur pompat e kogjenerimit dhe kemi rikthyer në punë sistemin e ngrohjes rreth orës 15:00. Ndërsa pas dy ditësh, nga OE është rregulluar problemi me kablirin 10kV të dëmtuar më herët. Më 21 prill rreth orës 10:30, sërish është dëmtuar kabllin 10kV nga OE i angazhuar në rregullimin e kopshtit të ndërmarrjes (deri tani 4 herë i dëmtuar). Gjatë gjithë ditës së hënë (e cila ishte festë) kemi qenë në komunikim me shefat e ndërrimit për hapat, që duhet ndërmarrë, në mos shkaktimin e ndonjë avarie tjetër në mungesë të energjisë elektrike, me ç'rast kemi startuar me gjeneratorin dhe kemi asistuar në funksionalizimin e kontrollereve PLC, PC-ve, switch-ave dhe sistemin e mbajtjes së presionit të kogjenerimit. Nga OE është intervenuar vetëm në ora 19:00 në kablirin "B" të dëmtuar, mirëpo sërish kishte shpërthim, rrjedhimisht nuk është rregulluar problemi. Në të njëjtën kabllë është intervenuar sërish më 22 prill mirëpo pa sukses, ndërsa rreth orës 17:30 nga OE është filluar intervenimi në kablirin "A" dhe në



komunikim me KEDS-in rreth orës 20:50 jemi furnizuar me energji elektrike në primar të transformatorit dhe është funksionalizuar vetëm kabllit "A". Më datën 23 korrik, OE ka intervenuar në kabllin 10kV "B" të dëmtuar më herët, mirëpo pas testimit në datën 25.07.2025 nga KEDS, njëri nga përcuesit ka dalë të jetë sërish në lidhje të shkurtër. Pastaj, më datën 30.07.2025, nga OE Limit është bërë rregullimi i kabllit 10kV "B", më datën 18 gusht 2025 kemi komunikuar me Keds-in për vënien në tension të kabllit, ndërsa në datën 08.09.2025 kemi komunikuar KEDS-in për të bërë fazimin e kabllit "B".

- Më datën 04 dhjetor, nga ora 09:10- 09:35 sërish është ndaluar energjia elektrike dhe sipas punëtorëve të KEDS-it problemi ishte me kabllin kryesor "B" të furnizimit me tensionin e mesëm 10kV, i cili është dëmtuar, prandaj edhe kemi kaluar në furnizimin me kabllin "A". Shpejt kemi reagu duke bërë pagesën për angazhimin e kamionit testues të KEDS-it, ndërsa në datën 05 dhjetor është bërë identifikimi i pozicionit të dëmtimit të kabllit nga ana e KEDS-it. Përmes email-it kam informuar komisionin e angazhuar për ndërtimin e ndërtesës së administratës dhe të njëjtit kanë informuar kompaninë "Limit" për të intervenuar në kabllin e dëmtuar nga ana e tyre disa muaj më herët dhe shfaqur problemet tani. Përveç saj, kam dërguar email në KEDS dhe është kërkuar për mundësinë e rregullimit të kabllit nga ana e tyre, të cilët janë përgjigjur pozitivisht. Për t'a plotësuar kërkesën e punëtorëve të KEDS-it dhe mundësinë që të intervenohet në kabllin e dëmtuar, më datën 12 dhe 13 kemi bërë prerjen e gypit të trashë, që ishte mbi kabllot e tensionit 10kV dhe kemi krijuar kushtet që të intervenohet nga ana e KEDS-it. Prandaj në datën 13 Dhjetor është rregulluar kabllit dhe në datën 15 Dhjetor është bërë testimi i kabllit "B" të tensionit 10kV nga KEDS-i. Më tej, kemi ndërprerë furnizimin e energjisë elektrike në ndërmarje, kemi bërë fazimin e kabllit "B", kemi rikthyer furnizimin e energjisë elektrike dhe tani në ngarkesë kemi kabllin "A" dhe rezervë kemi kabllin "B".
- Momentalisht, situata kabllore e furnizimit me energji elektrike të tensionit 10kV është e mbështetur në kablo të viteve 70-ta, mirëpo pas kërkesës së bërë, jemi në pritje të zgjidhjes teknike për dislokim të kabllove nga ana e KEDS-it.
- Më datën 20.03.2025, nga OE i angazhuar në rregullimin e oborrit të ndërmarjes është këputur kabllit optik me ç'rast është humbur komunikimi me stacionin "Bregu i Diellit" (edhe pse stacioni ishte në punë) dhe është zhveshur kabllit i tensionit 10KV për furnizimin e stacionit "Bregu i Diellit", e cila më vonë është rregulluar. Ndërsa me 27 mars, fillimisht është intervenuar përkohësisht në kabllin optik duke rikthyer komunikimin me stacionin "Bregu i Diellit" e pas disa muajsh është rregulluar edhe sipas standardeve.
- Janë kontrolluar përcuesit në mbrojtjet e tri pompave qarkulluese në stacionin "Bregu i Diellit" dhe të gjitha janë në rregull.
- Për disa orë, më 3 prill nuk kemi pasur informacionin për MW nga stacioni HES, prandaj kemi bërë matjen e sinjaleve për rrjedhjen dhe energjinë termike në kalkulatorin e energjisë, të cilat kanë rezultuar të jenë në rregull. Prandaj, kemi kuptuar se arsye e humbjes së tregimit të sinjalit për MW në SCADA ishte vetëm tejkalimi i limitit të marrjes së energjisë nga ajo, që është programuar në PLC dhe SCADA.
- Më datën 04.04.2025 kam rregulluar problemin me saktësinë e matjes për energjinë termike dhe kemi vërejtur se ky problem i matjes ishte nga viti 2014. Problemi ka dalë në sipërfaqe vetëm pas hapjes për inspektim të këmbjesit 1, nga e cila u paraqit tregimi i pasaktë i matjes së shpenzimit të energjisë termike, prandaj me këtë intervenim kemi shmangur tregimin e shpenzimit joreal të energjisë termike në kalkulator, rrjedhimisht në SCADA.
- Më datën 18.04.2025 kemi intervenuar në ndërprerësin e nivelit të lartë në rezervuarin e mbajtjes së presionit të kogjenerimit dhe konstatojmë se informacioni është i saktë.
- Më datën 15.04.2025, duke i respektuar normat e kërkuara kemi bërë ndërprerjen e ngrohjes, respektivisht përfundimin e sezonës ngrohëse 2024/2025 dhe me 16 prill kemi shkyçur mbrojtjet termike për inverterët Vfd të pompave 62P1 – 62P5.
- Më datën 11 qershor, pas ftesës së bërë kam qenë prezent në organizimin e Takimit Vjetor të Komitetit Nacional CIGRE Kosovë (përfaqësues nga NP "Termokos"), me ç'rast patëm mundësi të kemi shkëmbim përvojash me zyrtarë nga KEK, KOSTT dhe kompani private.
- Së bashku me gjitha divizionet e DPK është punuar në pastrimin e oborrit nga gjërat e forta, me qëllim të lirimit të hapësirave për shkak të asfaltimit, që ishte në plan të bëhet nga OE Limit.
- Më 17 korrik janë kontrolluar fatuat e energjisë elektrike nga KesCO, për periudhën e pakalkuluar nga fatura paraprake, respektivisht për ditët e fundit të muajit maj. Njëkohësisht, kam vërejtur një gabim nga ana e tyre, për të cilin janë informuar dhe lista e faturave ishte nënshkruar pa faturën në fjalë.



Fillimi i sezonës 2025/2026



- Për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike pa paralajmërim nga KEDS më datën 08 tetor, kemi pas problem në serverin 2 mirëpo pas hapjes së serverit kemi rregulluar atë.
- Më 06 tetor jemi takuar me koordinatorin për rrjetin në KEDS dhe është diskutuar rreth mundësisë për shfrytëzimin e trasesë së KEDS-it për shtrirjen e kabllos nga stacioni "Prishtina 6" deri në NP "Termokos". Kemi bërë kërkesën për zgjidhje teknike në KEDS dhe në datën 17.10.2025 kemi pranuar zgjidhje teknike dhe zgjidhja teknike e tyre kërkon kosto të lartë financiare. Më datën 23 tetor kemi pas takim me menaxhmentin e KEDS-it, në lidhje me shqyrtimin e mundësive të bashkëpunimit në ndërrimin e sistemit të shpërndarjes elektroenergjetike, të cilët brenda mundësive të veta kanë shprehur gatishmëri për të na ndihmuar. Më datën 24.10.2025 jam takuar me inxhinierin projektues nga KEDS-i, Fatmir Jashari, me të cilin detajisht kemi shikuar pjesën e trasesë së KEDS-it, që mund të shfrytëzohet nga ana jonë. Meqenëse, nga menaxhmenti i NP "Termokos" është kërkuar, që të shikohen mundësitë e zgjidhjes së trasesë përmes komunës së Prishtinës, është bërë kërkesë në Kuvendin Komunal për ndihmë eventuale. Pas informimit nga ana e komunës për mosposedimin e kanaleve kabllovlake më datën 08 dhjetor dhe pamundësisë nga ana e tyre për të na ndihmuar, ne kemi vazhduar punën me mundësitë e ofruara nga KEDS-i. Prandaj më datën 11.12.2025, në KEDS është dorëzuar "Kërkesë për dislokim të kabllos 10kV/20kV" dhe jemi në pritje të përgjigjes teknike për dislokim të kabllove, për të vazhduar tutje me pëlqimin në Komunën e Prishtinës, për punët, që duhet të bëhen;
- Në fillimin e sezonës 2025/26 është paraqitur problemi me kalkulatorin e energjisë termike në stacionin HES, me ç'rast pas fillimit të marrjes së energjisë kalkulimi ishte 100% më i lartë se ai real dhe nëse vazhdohej ashtu do të kishte edhe dëmtim financiar për ndërmarrjen, mirëpo kemi rregulluar problemin në fjalë;
- Janë instaluar dy reflektorë në ngrohtoren e spitalit, pas prishjes së reflektorëve të vendosur nga ana e NPB-së;
- Më datën 09 nëntor, në qendër është verifikuar se një pompë në distribuim ishte djegur;
- Më datën 12 dhe 13 nëntor kam qenë në punëtorinë e organizuar nga FOPIP në "Sirius";
- Pas ardhjes së kontejnerit të ri në stacionin HES, kemi shqyrtuar furnizimin me energji elektrike nga kontejneri i vjetër dhe kemi bërë kyçjen në kontejnerin e ri;
- Është bërë një modifikim për mundësi më të lehtë të resetimit në pajisjen e ndërprerësit të shtypjes në stacionin HES.
- Më datën 01.12.2025 si Department i prodhimit ishim në takim me personat udhëheqës të "Kosova B" në KEK, për të diskutuar në lidhje me energjinë termike dhe ndikimi në KEK i ndërprerjeve pa paralajmërim të energjisë elektrike në NP "Termokos";
- Më datën 05.12.2025, në ora 13:30 kemi pasur humbje të komunikimit me kontrollerat e kogjenerimit përfshirë sistemin e mbajtjes së presionit të kogjenerimit, me përjashtim të kontrollerit, që përfshinë pompat qarkulluese të distribuimit. Prandaj, pompat qarkulluese të rrjetit ishin në punë ndërsa ato të kogjenerimit janë ndalur, mirëpo pas shumë përpjekjeve kemi arritur që t'a kthejmë sistemin në punë, duke rikthyer komunikimin në funksion;
- Në stacionin në HES, janë izouluar disa fije përçuesish të dëmtuar ndër vite nga brejtësit;
- Më datën 11 dhjetor është asistuar divizioni i PKU në marrjen e mostrës nga analizatori i PKU-së dhe funksionalizimin e sistemit;
- Për shkak të rënies së shpeshtë të bllokut B1 dhe B2 në KEK në fillimin e sezonës 2025/26, ka bërë që herë herë planifikimi i energjisë elektrike të jetë i pamundur, për të cilin fakt kam informuar me email edhe KEK-un si furnizues me energji elektrike;
- Më datën 22.12.2025 jemi përgjigjur në komentet e ZRRE-së për pjesën e planifikimit të shpenzimit të energjisë elektrike;
- Më datën 24.12.2025, në KEDS kam bërë kërkesën për pasivizimin e gjashtë njëhësorëve të energjisë elektrike, si vijon: DPR90007146, DPR90007147, DPR90007149, DPR90007150, DPR90007160 dhe DPR90007161 (të gjitha me adresë në Bresje) dhe të njëjtat sipas KEDS-it në mundësinë më të hershme do të largohen nga emri i NP "Termokos".



1. Strategia e planifikimi i punës 2. Organizimi i punës 3. Menaxhimi i punës 4. Kontrollimi i punës 5. Raporti i punës



Divizioni i PKU-së

Gjatë periudhës raportuese në Divizionin e përgatitjes kimike të ujit, bazuar edhe në planin aksional 2025, janë realizuar këto punë:

Divizioni i Përgatitjes Kimike të Ujit (PKU), që përbëhet nga gjithsej 4 nëpunës: udhëheqësi i divizionit, ing. përgjegjës dhe dy laborantë, operon në kuadër të Departamentit të prodhimit- kogjenerimit (DPK) dhe ka përcaktuar qartë objektivat për vitin 2025, duke plotësuar me përshkrim aktivitetet e nevojshme për realizimin e tyre si dhe ka hartuar Planin aksional për sezonën e verës, që kishte për qëllim përgatitjet për sezonën ngrohëse 2025/ 2026.

Objektivat kryesore të PKU-së kanë qenë prodhimii ujit kimikisht cilësor, pastrimi kimik i kaldajave dhe këmbyesëve të nxehtësisë në stacionin qendror dhe të termoñnstacioneve, mirëmbajtja e pajisjeve, ruajtja e kemikaleve sipas normave, hartimi i specifikave teknike për furnizim me pajisje dhe kemikale dhe raportimi.

PKU objektivat, detyrat dhe përgjegjësitë e veta i ka realizuar në bashkëpunim të ngushtë me Divizionet në kuadër të DPK dhe departamenteve tjera, duke iu përgjigjur çdo kërkesë a nevojë të tyre, që bie në fushën e përgjegjësisë të DPKU.

Gjatë periudhës 2025, PKU është ballafaquar me një mori sfidash për shkak të problemeve teknike në sistemin e zbutjes së ujit të dedikuar për furnizim me ujë kimikisht të përgatitur në rrjetin e kogjenerimit, pasi që edhe gjatë këtyre muajve kemi operuar vetëm me njërin zbutës të ujit, zbutësin nr. 1, sepse zbutësi nr. 2 ka qenë jashtë funksionit, për shkak të problemeve teknike deri në fund të përfundimit të sezonës ngrohëse 2024/2025. Në fillim të sezonës ngrohëse 2025/2026 na kanë përcjellë të njëjtat probleme me zbutësit e ujit për sistemin e kogjenerimit deri në fillim të dhjetorit, kur edhe është realizuar servisi/riparimi i zbutësve dhe tanimë janë funksional. Edhe pse gjatë kësaj periudhe kohore nuk janë evidentuar humbje në sistemin e kogjenerimit. Por, mund të konstatohet se gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka pasur probleme me furnizim me ujë kimikisht të përgatitur. Të dhënat statistikore të përgatitjes kimike të ujit të zbutur janë dhënë në tabelë.

Po ashtu, dozimi me hidroksid të natriumit, sulfidnatriumi dhe fosfat të natriumit, me qëllim të kondicionimit të ujit në rrjetin e distribuimit dhe kogjenerimit, nuk ka mundur të realizohet për shkak se pajisja për dozim e instaluar nga operatori ekonomik ka qenë jofunksionale. Por, mund të konstatojmë se në momentin e raportimit tanimë janë funksionale edhe të dyja sistemet e zbutjes së ujit dhe të dyja sistemet e dozimit të kemikaleve për kondicionim të ujit.

Në kuadër të realizimit të Planit aksional 2025 është realizuar pastrimi kimik këmbyesëve të nxehtësisë sipas kërkesave të termoñnstacioneve të distribuimit dhe këmbyesve të nxehtësisë HRS Sondex 1si dhe kaldajat K1, K2 të ngrohësorës së spitalit dhe kaldajës K4 në Termokos dhe punë të tjera të cilat janë paraqitur në tabelën IV.

Sipas gjendjes së njehsorit të ujit e lexuar më 31.12.2025, rezulton se në sistemin e kogjenerimit nuk janë evidentuar 956m³humbje/ujë i futur në rrjet.

Sipas llogaritjeve rezulton se në sistemin e distribuimit, 01.01.2025 - 31.12.2025, kanë hyrë 82854m³ ujë kimikisht i përgatitur.

Sipas gjendjes së njehsorit të ujit, e lexuar më 31.03.2024, rezulton se janë prodhuar 77222m³ ujë i përgatitur në sistemin e filtrave jonkëmbyes, dedikuar për rrjetin e distribuimit.

Në bazë të evidencës nga raportet ditore nga 01.01.2025 deri më 31.03.2025 janë shpenzuar 70725kg kripë NaCl.

Vazhdimisht janë përcjellë parametrat e ujit, fortësia e ujit, në sistemin e distribuimit, në filtrat jonkëmbyes, në rezervarin ditor, në kolektor në dalje, në kolektor në hyrje dhe në sistemin e kogjenerimit, në rezervarin ditor dhe në hyrje të këmbyesëve të nxehtësisë në termostacion në "Termokos" dhe mund të konsiderojmë se vlerat mesatare të fortësisës së ujit janë brenda kufijve të lejuar.

Vlenë të përmendet se gjatë këtij viti kalendarik na kanë përcjellë edhe vështirësi në operim, por me një bashkëpunim të ndërsjellë kemi arritur që bashkarisht t'i tejkalojmë.

Bashkëpunimi në mes tri divizioneve në kuadër të departamentit ka qenë i koordinuar mirë në vitin 2025.

Bashkëpunimi i jashtëzakonshëm dhe i kordinuar shumë mirë ka qenë edhe mes DPK-së dhe zyrtarëve të KEK-ut, KRU-së si dhe me departamentet tjera në kuadër të NP "Termokos" Sh.A.



Të dhënat statistikore në formë tabelare për punët e kryera gjatë periudhës 2025:

Prodhimi i ujit kimikisht të përgatitur dhe shpenzimet e kripës NaCl për regjenerim të filtrave jonkëmbyes:


Tabela 18. Të dhënat tabelare dhe statistikore të përgatitjes së ujit dhe shpenzimet e kripës NaCl:

Data	Ujë i futur në rrjet të distribuimit / m ³	Ujë i përgatitur (sistemi i vjetër) m ³	Ujë i përgatitur dhe i futur në rrjet (sistemi i ri-koogjnerim)/ m ³	Gjithsej ujë i përgatitur	Shpenzimet e kripës NaCl (24 orë)/kg
Janar	11447	11097	0	11097	9425
Shkurt	10868	10231	0	10231	8450
Mars	11753	11498	0	11498	10575
Prill	13476	9672	391	10063	8350
Shtator	11241	11885	1	11886	11200
Tetor	11848	11387	291	11678	10325
Nëntor	12221	11452	273	11725	12400
Dhjetor	11836	11032	136	11168	10103
Mesatarja	82854	77222	956	78178	70725
Gjithsej	11447	11097	0	11097	9425

Pastrimi kimik i këmbyesëve gjatë periudhës raportuese 2025

Tabela 19. Pastrimi kimik i këmbyesëve gjatë periudhës raportuese 2025

Muaji	Nr. i këmbyesëve
Janar	6
Shkurt	6
Mars	
Prill	
Maj	
Qershor	
Korrik	9
Gusht	48
Shtator	24
Nëntor	
Dhjetor	2
Gjithsej	95







Në vitin 2025 janë instaluar 960.7 metër gyp me paraizolim dhe 466.5 metër gyp çeliku.

Instalimi i gypave metër gjatësi në vitin 2025:

1,427m'

Figura 8. Instalimi i gypave të paraizoluara dhe të çelikutë



© Zgjerimi i rrjetit në disa objekte banesore në Lakrishtë 09/2025

DEPARTAMENTI I DISTRIBUIMIT

Aktivitetet e Departamentit të distribuimit

Gjatë vitit 2025, Departamenti i distribuimit ka pasur këto aktivitete:

- Intervenimet në sistemin primar të ngrohjes:
 - Instalimi i gypave;
 - Instalimi i kthesave;
 - Instalimi i valvolave;
 - Instalimi i filtrave;
 - Instalimi i pompave;
 - Instalimi i këmbyesëve;
 - Pastrimi i këmbyesëve.
- Intervenimet në sistemin sekondar të ngrohjes:
- Instalimi i matësve të energjisë;
- Kycjet e reja;
- Puna me palë të treta;
- Aktivitete tjera.

Instalimi i gypave

Gjatë periudhës raportuese janë instaluar gjithsej 1,427.2 metër gyp, prej të cilave 960.7 metër gyp i paraizoluara si dhe 466.5 metër gyp çeliku.

Tabela 20. Pasqyra përmbledhëse e aktiviteteve të Departamentit të distribuimit gjatë vitit 2025

nr	Aktiviteti	totali	Njësia
1	Intervenimet në rrjetin primar të ngrohjes		intervenime
2	Intervenimet në rrjetin sekondar të ngrohjes	32	intervenime
3	Instalimi i gypave të paraizoluara të çelikut	1,427	m'
4	Instalimi i kthesave paraizoluara të çelikut	147	copë
5	Instalimi i këmbyesëve të nxehtësisë	2	copë
6	Instalimi i valvolave të ngrohjes	47	copë
7	Instalimi i pompave qarkulluese	17	copë
8	Instalimi i filtrave	2	copë
9	Instalimi i matësve të energjisë	1	copë

Tabela 21. Instalimi i gypave janar-dhjetor 2025

Nr.	Dim. i gypit	Realiz.	Vërejtje
1	DN 32	428	Gyp me paraizolim prej të cilave 278m gyp çeliku
2	DN 40	216	54 m gyp çeliku 162 m gyp me paraizolim
3	DN 50	235	77 m gyp çeliku 158 m gyp me paraizolim
4	DN 65	182	26 m gyp çeliku 156 m gyp me paraizolim
5	DN 80	138.5	108m gyp me paraizolim, 30.5 m gyp çeliku
6	DN100	49	48 gyp me paraizolim, 1 m gyp çeliku
7	DN125	134	Gyp me paraizolim
8	DN150	1.2	Gyp me paraizolim
9	DN200	2	Gyp me paraizolim
10	DN250	41.5	Gyp me paraizolim
TOTAL		1,427.2	

Instalimi i kthesave


Në peridhën raportuese janar-dhjetor 2025 janë instaluar gjithsej 147 kthesa, prej të cilave 79 kthesa të çelikut dhe 68 kthesa me paraizolim.

Tabela 22. Instalimi i kthesave

Nr.	Dim. i ktheses	Realizimi	Vërejtje
1	DN32	30	14 Kthesa me paraizolim, 16 kthesa çeliku
2	DN40	37	21 Kthesa me paraizolim, 16 kthesa çeliku
3	DN50	10	7 kthesa me paraizolim, 3 kthesa çeliku
4	DN65	22	prej të cilave 2 kthesa me paraizolim
5	DN80	18	7 kthesa me paraizolim, 11 kthesa çeliku
6	DN100	17	9 Kthesa me paraizolim, 8 kthesa çeliku
7	DN125	4	Kthesa me paraizolim
8	DN150	4	4 Kthesa çeliku
9	DN250	5	2 kthesa me paraizolim, 1 kthesa çeliku
TOTAL		147	



Figura 9. Paraqitja grafike e instalimit të kthesave, valvolave, pompave, filtrave, këmbysesë dhe matësve të energjisë gjatë vitit 2025



© Zgjerimi i rrjetit të ngrohjes në I. L'akrishtë

INSTALIMI I POMPAVE, VALVOLAVE, FILTRAVE, KËMBYESËVE DHE MATËSVE TË NXEHTËSISË

Instalimi i pompave

Në periudhën raportuese janë instaluar 17 pompa.

Tabela 23. Instalimi i pompave

Nr.	Dim. pomp	Realizimi	Vërejtje
1	DN 25	1	
2	DN 40	2	
3	DN50	8	një pompe e vjetër
4	DN65	3	Nënstacion
5	DN80	1	pompë e vjetër
6	Wilo	2	Të perdorura
TOTAL		17	Copë

Instalimi i valvolave

Janë instaluar gjithsej 47 valvola të dimensionit DN 32, DN 40, DN 50, DN 65, DN 80, DN 100 dhe DN 125.

Tabela 24. Instalimi i valvolave

Nr.	Dim. i valv.	Realizimi	Vërejtje
1	DN 32	4	
2	DN 40	3	
3	DN 50	10	
4	DN 65	14	
5	DN 80	7	
6	DN 100	5	
7	DN 125	4	
TOTAL		47	Copë

Instalimi i filtrave

Gjatë vitit 2025, janë instaluar gjithsej 2 filtra të dimensioneve DN 40, dhe DN 65.

Tabela 25. Instalimi i filtrave

Nr.	Dimensioni i gypit	Realizimi	Vërejtje
1	DN40	1	MP Group- rr. Ali Pasha
2	DN 65	1	Rr. B 6/2 "Dardani"
TOTAL		2	

Këmbyesit e nxehtësisë

Në vitin 2025 janë instaluar gjithësej 2 këmbyes të nxehtësisë

Tabela 26. Instalimi i këmbyesëve të nxehtësisë

Nr.	Lloji dhe fuqia	Realizimi	Vërejtje
1	1000 kw	1	Biloku 9/2
2	800kW	1	Nënstacion
TOTAL		2	

Pastrimi i këmbyesëve të nxehtësisë

Është bërë pastrimi me kemikate i 89 këmbyesëve të nxehtësisë.

Tabela 27. Pastrimi i këmbyesëve të nxehtësisë

Nr.	Adresa	Realizimi	Vërejtje
1	Në adresa të ndryshme	89	Pastrimi me kemikate

Matësit e nxehtësisë

Gjatë periudhës raportuese, është instaluar gjithsej 1 matës i nxehtësisë.

Tabela 28. Matësit e energjisë

Nr.	Rajoni	Adresa	Lloji	Realiz.	Data
1	ULP.	QKUK – Dekanati i mjekësisë	DN80 – 40m3/h	1	02.2025
TOTAL				1	

Intervenimet në rrjetin sekondar

Në vitin 2025, janë realizuar 32 intervenime në rrjetin sekondar

Tabela 29. Intervenimet urgjente në pjesën sekondare

Nr.	Rajoni	Adresa	Interven.	Përshkrimi i punëve
1	Dardani, Qendër	Të ndryshme	32	Sanimi i rrjedhjes
		Gjithsej	32	

Kyçjet e reja

Në vitin 2025, janë kyçur në rrjetin e ngrohjes gjithsej 3 objekte si dhe 2 kyçje me ofertë.

Tabela 30. Kyçjet e reja në rrjetin primar gjatë vitit 2025

Nr.	Adresa	Siperfaqja m2	Vërejtje
1	Xhamia Kadërie	500	-
2	Anton Çetta Nr 5-, Aktash	200	-
3	Rr. Filip Shiroka, nr. 11	350	Kyçje e re
4	Rr. Filip Shiroka, nr. 13	230	Kyçje e re
TOTAL		1,280	



DEPARTAMENTI I FURNIZIMIT

Aktivitetet e Departamentit të Furnizimit gjatë periudhës janar-dhjetor 2025

Në bazë të planit për ngritjen e arkëtimit përfshirë edhe borxhet është përgatitur plani i aktiviteteve operacionale për arkëtim të borxheve të vjetra.

Faturimi

Faturimi gjatë periudhës raportuese 2025 është si në vijim:

Tabela 31. Faturimi në vitin 2025:

Periudha	Sektori i amvisërisë	Sektori afarist	Totali
Janar-2025	1,180,646.18 €	856,851.27 €	2,037,497.45 €
Shkurt-2025	1,160,583.11 €	809,331.16 €	1,969,914.27 €
Mars-2025	1,006,558.04 €	650,795.63 €	1,657,353.67 €
Prill -2025	480.905.57 €	365,587.65 €	846,493.22 €
Maj-2025	0.00 €	30,043.02 €	30,043.02 €
Qershor-2025	5,452.27 €	37,846.81 €	43,299.08 €
Korrik-2025	6,937.67 €	3,405.78 €	10,343.45 €
Gusht-2025	1,523.01 €	0.00 €	1,523.01 €
Shtator-2025	481.08 €	1,493.71 €	1,974.79 €
Tetor-2025	621,265.51 €	416,769.97 €	1,038,035.48 €
Nëntor-2025	958,443.92 €	610,824.41 €	1,569,268.33 €
Dhjetor-2025	1,119,527.14 €	816,096.31 €	1,935,623.45 €
2025	6,542,323.50 €	4,599,045.72 €	11,141,369.22 €

Për muajt jashtë sezonit ngrohës respektivisht maj- shtator 2025, në raportin përmbledhës vjetor 2025 janë paraqitur edhe faturimi retroaktiv në vlerë totale prej 87,173 euro.

Krahasuar me vitin e kaluar 2024, faturimi në vitin 2025 është më i vogël për 215,817 euro, respektivisht rreth 1.9%.

Inkasimi

Të hyrat e përgjithshme nga arkëtimi i mjeteve në vitin 2025 janë si vijon:

Tabela 32. Inkasimi në vitin 2025:

Sektori	Sektori i amvisërisë	Sektori afarist	Total inkasimi €
Total inkasimi	6,232,557 €	4,125,193 €	10,357,750 €

Në vazhdim në mënyrë tabelare dhe grafike paraqesim të dhënat e inkasimit për periudhën raportuese 2025 si dhe krahasimin me vitin 2024.

Vlera e faturuar e energjisë termike në janar-dhjetor 2025 është: 215,817 euro më pak se në vitin paraprak 2024.

Rënja e faturimit krahasuar me vitin paraprak, shprehur në përqindje

-1,9%

Figura 10. Faturimi në janar-dhjetor 2025, krahasimi me janar-dhjetor 2024





Tabela 33. Inkasimi në 2025, krahasimi me 2024:

Periudha	2025	2024	Evaluimi	
			€	%
Sektori i amvisërisë	6,232,557	5,745,374	487,183	8%
Sektori afarist	4,125,193	5,051,339	-926,146	-18%
Totali	10,357,750	10,796,713	-438,963	-4%

Figura 11. Inkasimi në vitin 2025, krahasimi me inkasimin në vitin 2024:



Të hyrat nga arkëtimi i mjeteve për vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak 2024, kanë qenë më të vogla për 4%, shprehur në vlerë monetare **438,616€**.


Krahasimi i inkasimit në faturim për janar-dhjetor 2025

Të hyrat e inkasuara nga faturimi për periudhën janar-dhjetor 2025 janë si vijon:

Tabela 34. Shkalla e inkasimit në janar-dhjetor 2025

	Faturimi	Inkasimi	Eval. €	Eval. %
Amvisëri	4,601,342 €	3,021,575 €	1,579,767 €	65.67%
Afarist	6,540,027 €	3,876,045 €	2,663,982 €	59.27%
Total	11,141,369 €	6,897,620 €	4,243,749 €	61.91%

Figura 12. Shkalla e inkasimit në janar-dhjetor 2025





Krahasuar me vitin paraprak 2024, në vitin 2025, kemi rritje të numrit të konsumatorëve aktiv për 482 konsumatorë më shumë dhe kemi rritje të sipërfaqes ngrohëse aktive për 68,685 m²

Rritje e sipërfaqes ngrohëse aktive prej

3,1%



DEPARTAMENTI I FURNIZIMIT

Numri aktual i konsumatorëve

Numri i përgjithshëm i konsumatorëve aktiv në fund të periudhës raportuese është 25,597 konsumatorë. Ndërsa, në fund të vitit 2024, numri i përgjithshëm i konsumatorëve aktiv ishte 25,115. Pra, kemi rritje të numrit të konsumatorëve aktiv prej 1.9%

Raporti i ankesave dhe kërkesave gjatë vitit 2025

Në vijim në mënyrë të përmblodhur në formë tabelare paraqesim raportin mbi ankesat dhe kërkesat gjatë vitit 2025.

Tabela 35. Raporti mbi ankesat dhe kërkesat gjatë vitit 2025

muaji	Ankesa të pranuar	Përgjigjet në ankesa	Kërkesa të pranuar	Përgjigjet në kërkesa
Janar	812	408	174	174
Shkurt	578	401	122	70
Mars	384	1183	87	138
Prill	193	247	82	87
Maj	101	431	67	108
Qershor	39	173	28	30
Korrik	35	132	58	22
Gusht	76	119	124	50
Shtator	58	150	210	58
Tetor	123	169	487	114
Nëntor	51	85	175	291
Dhjetor	271	158	245	209
TOTAL	2721	3656	1859	1351

Sqarim: Janë përfshirë përgjigjet edhe për ankesa dhe kërkesa të bartura nga viti paraprak.

Kontratat për furnizim me ngrohje

Në vitin 2025, me 1,088 konsumatorë janë nënshkruar kontratat për furnizim me ngrohje, prej të cilave 941 kontrata nga sektori i amvisërisë dhe 147 nga sektori afarist.

Sipërfaqja ngrohëse

Në fund të periudhës raportuese 2025, sipërfaqja ngrohëse aktive është 2,283,710 m². Ndërsa, në fund të vitit 2024, sipërfaqja ngrohëse aktive ishte 2,215,025 m².

Figura 13. Sipërfaqja në fund të periudhës 2025, krahasimi me 2024



Kyçjet e reja

Në vitin 2025, në sistemin e ngrohjes qendrore "Termokos", janë kyçur gjithësej 286 konsumator të rinj me sipërfaqe prej 22,137m².

Tabela 36. Konsumatorë të rinj – Kyçje të reja në vitin 2025

Sektori	Numri i konsumatorëve	Sipërfaqja m ²
Amvisëri	235	16,708.88 m ²
Afarist/institucional	51	5,428.12 m ²
Total	286	22,137 m ²





DEPARTAMENTI PËR ZHVILLIM DHE INVESTIME KAPITALE

NJËSIA PËR IMPLEMENTIMIN E PROJEKTEVE

Qëllimi i raportit- Ky raport vjetor paraqet një përmbledhje të konsoliduar të aktiviteteve, progresit teknik, financiar dhe institucional të Departamentit për zhvillim dhe investime kapitale gjatë vitit 2025. Raporti është përgatitur në bazë të aktiviteteve gjatë vitit 2025.

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Gjatë vitit 2025, Departamenti për zhvillim dhe investime kapitale ka qenë i angazhuar intensivisht në zhvillimin dhe avancimin e dy projekteve strategjike të NP "Termokos" Sh.A.:

- Projekti "Solar4Kosovo II – Solar District Heating", i financuar nga KfW, BERZH, WBI dhe burime vendore;
- Projekti për dyfishimin e kapaciteteve të kogjenerimit dhe rrjetit transmetues nga 140 MWth në 280 MWth, i financuar nga EIB, BE dhe Qeveria e Republikës së Kosovës;
- Projekti: Studimi i fizibilitetit për mbulueshmërinë e qytetit të Prishtinës me ngrohje qendrore – 11 zona të reja

Viti 2025 është karakterizuar nga përparime substanciale në fazën e projektimit teknik, konsolidimit të dokumentacionit mjedisor dhe social, koordinimit me institucionet financiare ndërkombëtare (IFI), si dhe përgatitjes së dosjeve të tenderimit. Paralelisht, janë adresuar sfida të rëndësishme, që lidhen me shpronësimet, lejet administrative dhe vonesat institucionale, veçanërisht në kontekstin e masave të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës.

PROJEKTI "SOLAR4KOSOVO II – SOLAR DISTRICT HEATING"

Komponentët kryesor të projektit:

- Impianti diellor për ujë të ngrohtë;
- Rezervuari sezonal për ruajtje të energjisë termike (PTES);
- Pompa termike me absorpcion (AHP);
- Tubacionet lidhëse – koridori A dhe koridori B;
- Zgjerimi i rrjetit të ngrohjes në lagjet e reja të Prishtinës.

Objektivat e projektit:

- Dekarbonizimi i sistemit të ngrohjes qendrore në Prishtinë;
- Ofrimi i shërbimeve të ngrohjes nga burime të ripërtëritshme;
- Prodhim vjetor i energjisë nga BRE rreth 43 GWh/vit;
- Ulja e emetimeve të CO₂ rreth 47,000 ton/vit;
- Jetëgjatësi e impiantit diellor 25–30 vjet.

Statusi i projektit gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025 janë arritur këto rezultate kryesore:

- Përfundimi i koncept-dizajnit dhe dizajnit teknik për impiantin diellor, PTES dhe ndërtesën energjetike;
- Finalizimi i raportit për sigurinë e digës dhe shqyrtimi i tij nga paneli i ekspertëve të pavarur (PoE), me rekomandime të integruara në dokumentet e tenderit;
- Dakordimi i kapacitetit të pompës termike me absorpcion prej 20 MW;
- Përfundimi dhe publikimi i Strategjisë së Komunikimit dhe Dukshmërisë (C&V), përfshirë lansimin e faqes zyrtare www.solar4kosovo2.org;
- Përditësimi dhe dorëzimi për "No Objection" i dokumenteve ESIA, ESMP, SEP dhe LALRP;
- Aprovimi dhe prezantimi publik i Master planit për zgjerim;
- Përfundimi i elaboratit të shpronësimit për koridorin A dhe dorëzimi i tij në MMPHI;

- Nënshkrimi i Marrëveshjes së mirëkuptimit për përdorimin e koridorit rrugor për koridorin B.

Aktivitetet kryesore gjatë vitit:

- Takime djavore koordinuese me konsulentin implementues (iC/CES) dhe NJZP (24 takime);
- Takime të rregullta progresi me KfW dhe BERZH (11 takime);
- Koordinim i vazhdueshëm me konsulentët FOPIP/ESAP (Aspiro, Enova) për përgatitjen e raportit nismëtar/diagnostik dhe zhvillimin e intervistave me departamentet përkatëse të "Termokos"-it;
- Finalizimi dhe publikimi i Planit të Angazhimit të Palëve të Interesit (SEP) në faqen zyrtare të "Termokos"-it, si dhe përditësimi i dokumenteve LALRP/LAP/LRP;
- Komunikimi dhe koordinimi i vazhdueshëm me institucionet financiare ndërkombëtare (IFI), konsulentët dhe autoritetet qeveritare lidhur me procedurat e tenderimit, aprovimet teknike dhe çështjet rregullative;
- Përditësimi i Master planit të zgjerimit dhe përcaktimi i prioritetëve për zonat "Lakrishte", "Kalabria", "Tophane", "Mahalla e muhaxherëve" dhe "Qyteti i vjetër", përfshirë simulimet hidraulike dhe verifikimin e kapaciteteve të rrjetit ekzistues;
- Vazhdim i nënshkrimit të para kontratave me objektet, që planifikohen të kyçen në rrjetin e ngrohjes qendrore, me qëllim të ruajtjes së projeksioneve të konsumit dhe stabilitetit të planifikimit;
- Miratim përfundimtar i raportit tremujor QR4, QR5 dhe QR6 nga "Termokos" dhe KfW, si dhe aprovimi i faturave përkatëse të konsulentit implementues;
- Dorëzimi i paketave kryesore të FOPIP-it, Planit të zhvillimit korporativ (CDP) dhe Planit të integruar të menaxhimit të aseteve, si bazë për forcimin e performancës financiare dhe operative të ndërmarrjes;
- Koordinim intensiv me Komunën e Prishtinës, Drejtorinë e kadastrit dhe MMPHI për çështjet e shpronësimit;
- Rishikim dhe harmonizim i dokumenteve mjedisore dhe sociale me BERZH dhe Enova;
- Përgatitje dhe vlerësim i fazës së para-kualifikimit për Lot 1, përfshirë rishpalljen e procedurës;
- Planifikim dhe definim i kërkesave teknike për integrimin e SCADA-s;
- Përgatitje e materialeve informuese dhe komunikim i vazhdueshëm me palët e interesit;
- Marrja e pëlqimeve parimore për kyçje në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve si dhe në sistemin energjetik (për impiantin solar);

Raportimi financiar – Solar4Kosovo II

- Totali CAPEX: 77,770,592 €
- Kontigjenca (12%): 9,332,471 €
- Totali i përgjithshëm i investimit: 87,103,063 €

Burimet e financimit:

- WBI Grant: 21,500,000 €
- Kredi KfW: 31,600,000 €
- Kredi EBRD: 18,900,000 €
- Kontribut vetanak: 15,103,063 €

PROJEKTI PËR DYFISHIMIN E KAPACITETEVE TË KOGJENERIMIT (EIB – ERI/ITA)

Përshkrimi i projektit

Projekti parasheh dyfishimin e kapacitetit të ngrohjes nga 140 MWth në 280 MWth, përmes ndërtimit të

linjës së tretë të transmetimit (DN800), stacioneve të reja HES2/HRS2 dhe zgjerimit të rrjetit të ngrohjes sipas Master planit të përditësuar.

Informacionet e projektit.

- Zgjerimi i kapacitetit të bashkëprodhimit-kogenerimit nga KEK-u (Korporata Energjetike e Kosovës);
- Rritja e prodhimit të nxehtësisë dhe energjisë së kombinuar (CHP) për rritjen e efikasitetit të energjisë;
- Kontributi në sigurinë dhe besueshmërinë energjetike të rajonit nëpërmjet kapaciteteve shtesë;
- Forcimi i partneriteteve dhe bashkëpunimit me KEK-un për përfitim reciprok dhe synime të përbashkëta energjetike;
- Zbatimi i projektit pritet në vitin 2028-2029
- Kostoja e projektit për dyfishimin e kapacitetit të ngrohjes: 63 milionë euro (financuar nga BE/BEI)
- Plani i dekarbonizimit – miratuar në janar 2024. Janë identifikuar projektet e investimeve afatshkurtra-qesme dhe afatgjata. Masat në EE në ndërtesa dhe BRE si burim i ngrohjes do të jetë fokusi kryesor, që për periudhën 2035-2050, kur planifikohet të kemi sistemin e ngrohjes qendrore të dekarbonizuar në Prishtinë.

Çështjet mjedisore:

- Me realizimin e projektit në total kemi ulje të emetimeve direkte të CO₂ në TC Kosova B si rezultat i dyfishimit të kapacitetit të ngrohjes;
- Ka një rritje të drejtpërdrejtë të emetimit të CO₂ (Td) prej 9,385 tCO₂/vit si rezultat i përmirësimit të infrastrukturës së "Termokos"-it,
- Ka një ulje të drejtpërdrejtë të emetimit të CO₂ (HMD) prej 106,833 tCO₂/vit si rezultat i ndryshimit të mënyrës së furnizimit me ngrohje nga ngrohja individuale në ngrohjen e hapësirës përmes rrjetit të NQ.

Ndikimi total i drejtpërdrejtë i CO₂ (TDId) i Projektit për dyfishimin e kapacitetit është i barabartë me: TDId = Td - HMD = 9,385 tCO₂/vit - 106,832 tCO₂/vit = - 97,447 tCO₂/vit < 0.

Sqarim: Nga kapaciteti gjenerues prej 140MW_{TH}, i cili do të realizohet me projektin për dyfishimin e kapaciteteve prodhuese të energjisë termike, 40 MW_{TH} energji termike do të ndahen për komunën e Obiliqit, ndërsa 100 MW_{TH} energji termike do të mbeten për NP "Termokos" Sh.A.

Komponentet e këtij projekti janë:

1. Ndërtimi i nënstationit për nxjerrjen e nxehtësisë në TE Kosova B (HES 2) dhe atij për pranim të nxehtësisë (HRS 2) në "Termokos" si dhe gypit të tretë me diametër DN800 mm, në trasenë eksistuese;
2. Zgjerimi i rrjetit, sipas Masterplanit të përditësuar, për të plasuar kapacitetet shtesë.

Master plani i zgjerimit

LAGJET E REJA që do të furnizohen me ngrohje:

"Prishtina e re"- afërsisht 960.000 m² (ndërtesa shumë banesore);

"Kalabria" afërsisht 60.000 m² (ndërtesa shumë banesore);

"Mati 1"-Rruga C, mbi 220.000 m² (ndërtesa shumë banesore).

Objektivat dhe përfitimet:

- Rritja e efikasitetit energjetik dhe sigurisë së furnizimit;
- Zëvendësimi i ngrohjes individuale me ngrohje qendrore;
- Ulje neto e emetimeve të CO₂ rreth 97,447 ton/vit;
- Kontribut afatgjatë në dekarbonizimin e sistemit të ngrohjes deri në vitin 2050.

Statusi i projektit gjatë vitit 2025:

- Përfundimi i dokumenteve bazë: Analiza ekonomiko-financiare, ESIA, Plani i implementimit, Strategjia e prokurimit, Master plani i zgjerimit dhe Strategjia e dekarbonizimit;
- Janë mbajtur 11 takime të progresit me Bashkimin Evropian, Bankën Evropiane për Investime, konsulentin "Tetratech", ku janë shqyrtuar progresi dhe çështje me rëndësi për zhvillimin e projektit;
- Finalizimi i specifikimeve teknike për HES, gypat e transmisionit dhe HRS;
- Përgatitja e draft dosjes së tenderit të prokurimit- dosjes së tenderit për punë dhe shërbime konsulente. Dokumenti për dosjen e tenderit për punë është dorëzuar në "Termokos" për rishikim dhe avancimi i procedurave për shpronësim;
- Miratimi përfundimtar i financimit nga Bordi i EIB në fund të vitit 2025;
- Sigurimi i grantit nga BE pas zbatjes së masave ndaj Kosovës;
- Dokumenti përmban: "Termokos" ende nuk ka dhënë përgjigje për komente.

Vëllimi I – Tenderi: Përfshin udhëzimet për ofertuesit, të dhënat e tenderit, format e ofertës, listat e çmimeve dhe normave, indeksimin e kostove dhe tabelat e vlerësimit të ofertave.

Vëllimi II – Kontrata: Përmban kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës, të dhënat kontraktuale, format e garancive (për performancë, parapagim dhe mbajtje), si dhe format për certifikata dhe marrëveshjen me bordin e arbitrazhit (DAAB).

Vëllimi III – Kërkesat e punëdhënësit: Përfshin kërkesat teknike të përgjithshme dhe të veçanta për punimet mekanike, elektrike, SCADA dhe civile, si dhe vizatimet përkatëse.

Vëllimi IV – Lokacionet dhe punimet: Përmban raportet e punimeve të riparimit në zonën "Laguna", matjet gjeodezike, të dhëna mbi rrjetet ekzistuese nëntokësore, vlerësimin mjedisor dhe planin e menaxhimit mjedisor e social, ndërsa kushtet e ndërtimit dhe sondazhi gjeoteknik do të shtohen më vonë.

Përmbajtja e dosjes së tenderit është e strukturuar në katër vOLUME kryesore, që mbulojnë aspektet administrative, kontraktuale, teknike dhe të lokacionit të punimeve.

- Është dorëzuar edhe raporti – dosja e tenderit S1 për shërbime konsulente-mbikqyrje, i cili është përgaditur nga konsulenti implementues "Tetratech".

Raportimi financiar- Projekti EIB:

- Totali i projektit: 63,371,961 €.

Burimet e financimit:

- Kredi EIB: 31,685,981 €
- IPA Grant: 17,600,000 €
- Qeveria e Kosovës: 9,000,000 €
- Kontributi i "Termokos": 5,085,981 €

SFIDAT KRYESORE GJATË VITIT 2025

- Zvarritja e proceseve të shpronësimit, veçanërisht për koridorin B;
- Vonesa në marrjen e lejeve mjedisore dhe teknike;
- Ndikimi i masave të BE-së në dinamikën e financimit;
- Komplexiteti i koordinimit ndërinstytucional.

Gjatë vitit 2025 në Departamentin për zhvillim dhe investime kapitale është trajtuar edhe projekti:

"STUDIMI I FIZIBILITETIT PËR MBULUESHMËRINË E QYTETIT TË PRISHTINËS ME NGROHJE QENDRORE- 11 ZONA TË REJA"

Të dhëna të përgjithshme për kontratën

Objekti: Studim fizibiliteti për zgjerimin e ngrohjes qendrore në 11 zona të reja të Prishtinës.

Kontrata ka përfunduar në afatin e paraparë dhe të gjitha dorëzimet janë pranuar zyrtarisht nga "Termokos".

Qëllimi dhe rëndësia strategjike e studimit:

Studimi kishte për qëllim vlerësimin teknik, mjedisor dhe financiar të zgjerimit të sistemit të ngrohjes qendrore në pjesët veriore dhe jugore të Prishtinës, në përputhje me:

- Strategjinë e dekarbonizimit të "Termokos";
- Objektivat kombëtare për energji dhe klimë;
- Kërkesat e institucioneve financiare ndërkombëtare (KfW, EIB, BE).

Studimi shërben si bazë teknike dhe financiare për fazën e implementimit të projekteve mëdha të zgjerimit të rrjetit, për lagjet, të cilat nuk janë të kyçura në sistemin e ngrohjes dhe nuk janë të parapara me Master planin e dy projekteve "Solar4Kosova II" dhe Projektin për dyfishimin e kapacitetit të kogjenerimit. Përfshirja e studimit:

- Pjesa veriore – lagjet: "Arbëri", "Kodra e trimave", "Qyteti i vjetër", "Kolovica", "Tasligje", "Velania" dhe pjesa jugore lagjet: "Hajvalia", "Prishtina e Re", "Qershia", "Nici", "Gorenje", "Qëndresa";
- U realizua ndarja e qytetit në 11 zona, 141 qeliza dhe 13,964 ndërtesa;
- U definuan metodologjitë për llogaritjen e kërkesës termike (TABULA, HDD, U-values).

Vlerësimi i kërkesës për ngrohje dhe kapaciteteve:

- U analizuan 3.93 milion m² sipërfaqe ndërtimore;
- Kërkesa totale për energji termike: ~1,810 GWh/vit;
- Kapaciteti optimal për zgjerim: ~130 MWth për 2,639 ndërtesa prioritare;
- U identifikuan zonat me densitet të lartë dhe fizibilitet ekonomik sipas kriterëve të BE-së (≥2000 kWh/m rrjet).

Analiza teknike e rrjetit dhe burimeve të nxehtësisë

U analizuan burime të ndryshme të sistemeve termike të dekarbonizuara:

- Solar termik + ruajtje sezonale (PTES) – opsioni më konkurrues afatgjatë;
- Kogjenerimi dhe nxehtësia e humbur nga Kosova B – zgjidhje tranzitore;
- Pompa termike, biomasa dhe gjeotermia – opsione plotësuese.
- U identifikuan lokacione strategjike për rezervuarë sezonalë (100,000–150,000 m³).
- U zhvillua koncepti i ndarjes hidraulike për të shmangur mbingarkimin e rrjetit ekzistues. Është llogaritur dhe dimensionuar rrjeta e ngrohjes bazuar në ngarkesën termike të secilit objekt në veçanti.
- U rekomandua integrimi i ujit të ngrohtë sanitar (UNS) për rritje të efikasitetit të sistemeve.

Zgjidhja e integruar Solar + CHP + PTES + Heat Pumps ofron fleksibilitet maksimal dhe ulje të ndjeshme të CO₂.

Vlerësimi mjedisor dhe social

Projekti është në përputhje me: Direktivën e BE 2011/92/EU, Ligjin për VNM të Kosovës, standardet EBRD dhe EIB.

- Ndikimet negative janë të përkohshme dhe të menaxhueshme (pluhur, zhurmë, mbetje).
- Përfitimet gjatë operimit:
 - Ulje e ndotjes së ajrit me 65–70 %;
 - Reduktim i ngrohjes individuale për >20,000 familje;
 - Përmirësim i shëndetit publik dhe cilësisë së jetesës.
- Raporti kosto-përfitim mjedisor: 1: 3.2.

Analiza ekonomike dhe financiare:

Investimi total i projektit: 227 milion € (2026–2029).

- Struktura optimale e propozuar e financimit:
 - 44 % grante;
 - 44 % kredi koncesionale;
 - 12 % kontribut i "Termokos".
- IRR ≈ 9 %, NPV > 40 milion €.
- "Termokos" ka:
 - Likuiditet të lartë;
 - Borxh minimal;
 - Kapacitet të mjaftueshëm për huamarrje.
- Tarifa e rekomanduar (~50 €/MWh) siguron rikuperim kostosh dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

Studimi përbën një bazë strategjike, teknike dhe financiare shumë solide për fazën e implementimit të zgjerimit të ngrohjes qendrore në Prishtinë. Ai e pozicionon "Termokos"-in si një ndërmarrje publike moderne, të dekarbonizuar dhe të bankueshme për investime mëdha afatgjata.

PËRFUNDIM

Viti 2025 ka qenë një vit kyç për konsolidimin e bazës teknike, financiare dhe institucionale të projekteve strategjike të NP "Termokos" SH.A. Departamenti për zhvillim dhe investime kapitale vlerëson se të dy projektet janë të pozicionuara për kalim në fazën e implementimit gjatë periudhës në vijim, me kusht të adresimit të çështjeve të mbetura administrative dhe shpronësuese.

Rekomandohet vazhdimi i bashkëpunimit të ngushtë me IFI-të, institucionet qeveritare dhe komunale, si dhe siguri i mbështetjes së vazhdueshme nga Bordi i Drejtorëve për realizimin me sukses të projekteve strategjike të ndërmarrjes.

Departamenti për zhvillim dhe investime kapitale është përgjegjës për planifikimin, zhvillimin, projektimin dhe mbikëqyrjen e projekteve kapitale të ndërmarrjes, si dhe për koordinimin me institucionet donatore dhe partnerët ndërkombëtarë (KfW, BERZH, EIB, etj.). Duke marrë parasysh volumin e madh të projekteve aktuale dhe atyre në proces të implementimit, si dhe zgjerimin e rrjetit të ngrohjes qendrore në kuadër të projekteve Solar4Kosovo II, Dyfishimi i kapaciteteve të kogjenerimit, dhe zgjerimi i rrjetit në lagje të reja, është bërë i domosdoshëm angazhimi i stafit profesional.

Aktualisht, numri ekzistues i stafit të rekrutuar nuk përbush nevojat teknike dhe operacionale për zhvillimin, dizajnimin, mbikëqyrjen dhe menaxhimin e projekteve, prandaj kërkohet hapja e konkurseve për pozitat e mëposhtme.

Pozitat për të cilat kërkohet hapja e konkurseve:

1. Koordinator për projektim dhe mbikëqyrje të projekteve;
2. Inxhinier i projektimit dhe mbikëqyrjes së punëve makinerike;
3. Inxhinier i projektimit dhe mbikëqyrjes së punëve ndërtimore;
4. Inxhinier i projektimit dhe mbikëqyrjes së punëve elektrike;
5. Zyrtar i GIS (Sistemi Informativ Gjeografik);
6. Zyrtar për mjedis, siguri dhe shëndet në punë.

Bazuar në planin e punës dhe strategjinë e zhvillimit të ndërmarrjes për periudhën 2025–2028, hapja e këtyre konkurseve konsiderohet e domosdoshme për funksionimin e rregullt të Departamentit dhe për zbatimin me efikasitet të projekteve kapitale në kuadër të "Termokos" SH.A.

Këto vende të punës janë të parapara në sistematizimin e vendeve të punës dhe në skemën ekzistuese organizative si dhe janë paraparë në Plan e buxhetit për vitin 2026.



TË ARRITURAT

Në fund të periudhës raportuese 2025, krahasuar me 2024 është arritur:

- Rritje e numrit të konsumatorëve 1.9%;
- Rritje e sipërfaqes ngrohëse 3.1%;
- Përparim në konsolidimin e departamenteve të reja;
- Progres në realizimin e projekteve për zgjerim të rrjetit;
- Ngritja e shkallës së qëndrueshmërisë afariste të ndërmarrjes.

SFIDAT

Gjatë punës në vitin 2025 sfidat më të mëdha kanë qenë:

- Ngritja e inkasimit;
- Arkëtimi i borxheve të vjetra të trashëguara;
- Ngritja e çmimeve, gjë e cila ka ndikuar në realizimin e projekteve ekzistuese dhe fillimin e projekteve të reja;
- Implementimi i rekomandimeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit;
- Procedurat e brendshme të departamenteve.

OBJEKTIVAT

Vazhdimi i ofrimit të shërbimeve të ngrohjes së qëndrueshme dhe kualitative për konsumatorët ekzistues dhe ata që do kycen;

- Realizimi i projekteve tjera në kuadër të Projektit të Kogjenerimit;
- Vazhdimi i reformimit të shërbimeve të administratës;
- Ngritja e nivelit të kontrollit të brendshëm;
- Vazhdimi i rehabilitimit dhe modernizimit të rrjetit të ngrohjes;
- Vazhdimi i zgjerimit të rrjetit konform masterplanit;
- Instalimi i njehsorëve digjital për konsumatorët e sektori të amvisërisë;
- Fillimi i faturimit të konsumatorëve banesor bazuar në energjinë e shpenzuar;
- Intensifikimi i bashkëpunimit me organet komunale dhe qendrore.

MASAT PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE TË NDËRMARRJES

Me qëllim të realizimit të objektivave të saj gjatë vitit 2023, siç janë qëndrueshmëria financiare e ndërmarrjes, ofrimi i ngrohjes më kualitative për qytetarët, reformimi dhe modernizimi i administratës, rritja e arkëtimit përfshirë edhe borxhet, realizimi i Projektit të kogjenerimit e tjera, janë paraparë këto masa:

- Ulja e metutjeshme e shpenzimeve operacionale;
- Kompletimi i akteve të brendshme administrative;
- Rehabilitimi teknik i rrjetit të distribuimit dhe njësisë së prodhimit;
- Zbatimi i masave operacionale për ngritjen e arkëtimit përfshirë edhe borxhet;
- Intensifikimi i punëve në realizimin e Projektit të kogjenerimit.

U.d. Kryeshefi Ekzekutiv:

Kastriot Bllaca

